FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 88

Tiranë – E martë, 13 qershor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 31/2023, datë 18.5.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW-së, Frankfurt Am Main (KfW), e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), (agjencia e zbatimit të projektit), për projektin "Zhvillimi i Integruar Rajonal"	9509
Dekret i Presidentit nr. 79, datë 8.6.2023	Për shpallje ligji	9523
Ligj nr. 32/2023, datë 18.5.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna/Bojana	9524
Dekret i Presidentit nr. 80, datë 8.6.2023	Për shpallje ligji	9527
Ligj nr. 36/2023, datë 25.5.2023	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve"	9527
Dekret i Presidentit nr. 81, datë 8.6.2023	Për shpallje ligji	9530
Ligj nr. 37/2023, datë 25.5.2023	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 27.4.2023, "Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, 'Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë', të ndryshuar"	9530
Dekret i Presidentit nr. 82, datë 9.6.2023	Për shpallje ligji	9530
Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 320, datë 31.5.2023	Për ngritjen e Task-Forcës për koordinimin e procesit të trajtimit të tokave bujqësore në përdorim, në kushtet e nenit 12, të ligjit nr. 20/2020	9530

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 344, datë 6.6.2023	Për delegim kompetencash.....	9532
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 347, datë 7.6.2023	Për një ndryshim në urdhrin nr. 438, datë 7.10.2008, "Për miratimin e rregullores 'Mbi kushtet e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve, të certifikatave të qumështit lëndë e parë dhe të produkteve me bazë qumështi për konsum human"', i ndryshuar.....	9532
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 21.5.2023	Çështja Hysa kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 52048/16).....	9533

LIGJ
Nr. 31/2023

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (HUAMARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KfW-së, FRANKFURT AM MAIN (KfW), E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH), (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT), PËR PROJEKTIN "ZHVILLIMI I INTEGRUAR RAJONAL"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW-së, Frankfurt am Main (KfW), e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), (agjencia e zbatimit të projektit), për projektin "Zhvillimi i integruar rajonal" sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 18.5.2023.

Shpallur me dekretin nr. 79, datë 8.6.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE HUAJE
datë 29.12.2022
NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN ("KfW") DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË ("HUAMARRËSI") DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) ("AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT")
PËR SHUMËN 20,000,000.00 EURO
- Zhvillimi i Integruar Rajonal -
BMZ-nr. 2018 67 175
Huaja nr. 30919

Përmbajtja

1. Huaja
2. Kanalizimi i Grantit për Agjencinë e Zbatimit të Projektit
3. Disbursimi
4. Tarifat
5. Interesi
6. Shlyerja dhe parapagimi
7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi
8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë
9. Paligjshmëria
10. Kostot dhe tarifat publike
11. Detyrime të veçanta
12. Zgjidhja e Marrëveshjes
13. Përfaqësimet dhe deklaratat
14. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Projektin
15. Dispozita të përgjithshme
Shtojca 1. Grafiku i disbursimit
Shtojca 2a. Zotimet e përputhshmërisë së Huamarrësit
Shtojca 2b. Zotimet e përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit

PREAMBULË

Baza për këtë marrëveshje huaje ndërmjet KfW-së, Huamarrësit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit ("**Marrëveshja**" ose "**Marrëveshja e Huas**") është marrëveshja e datës 27 janar 2021 lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar (BF) ("**Marrëveshja Qeveritare**").

Projekti financohet nga kjo Marrëveshje Huaje dhe marrëveshja shtesë e grantit për masat shoqëruese të asaj marrëveshjeje ("**Marrëveshja Shoqëruese e Grantit**") e lidhur në po të njëjtën datë (siç përkufizohet më poshtë).

KfW-ja do ta rifinancojë Huan e dhënë në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, me subvencione interesi nga fonde buxheti me interes të ulët të dhëna nga Republika Federale e Gjermanisë për projekte që i përmbushin kriteret e pranimit të politikave të zhvillimit. Termat dhe kushtet e Huas janë në përputhje me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes për njohje si Asistencë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

Mbi këtë bazë dhe me kusht që Republika Federale e Gjermanisë të japë garanci për Huan, KfW-ja do të japë një hua në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje.

1. Huaja

1.1 *Shuma.* KfW-ja i ofron Përfituesit një Hua deri në shumën

20,000,000.00 euro (njëzet milionë euro) (Huaja)

1.2 *Qëllimi.* Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, do ta kanalizojë Huanë plotësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2.1. Agjencia për Ekzekutimin e Projektit e përdor Huan vetëm për investime infrastrukturore të qëndrueshme, miqësore me mjedisin dhe klimën në bashkitë e përzgjedhura ("**Projekti**"). Detajet e Projektit, si dhe furnizimet e shërbimet që do të financohen nga Huaja do të përcaktohen me marrëveshje të veçantë, lidhur midis Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së, e cila do të nënshkruhet sikurse lexohet dhe dakordësohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që përfaqëson Huamarrësin ("**Marrëveshja e veçantë**").

1.3 *Taksat, tarifat dhe detyrimet doganore.* Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të shlyhen nga Huamarrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, si dhe tatimet doganore nuk do të financohen nga Huaja.

2. Kanalizimi i Grantit për Agjencinë e Zbatimit të Projektit

2.1 *Marrëveshja kanalizuese.* Huamarrësi e kanalizon Huan tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në formën e një granti të pashlyeshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 *Përkthimi i certifikuar.* Para disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi i dërgon KfW-së përkthimin e certifikuar të marrëveshjes së financimit të përmendur në nenin 2.1.

2.3 *Jo detyrime për Agjencinë e Zbatimit të Projektit.* Kanalizimi i Huas nuk përbën detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje.

3. Disbursimi

3.1 *Kërkesat për disbursim.* Sapo të përmbushen të gjitha kushtet paraprake për disbursimin sipas nenit 3.3 (*Kushtet paraprake të disbursimit*), KfW-ja do ta disbursojë Huan në pajtim me progresin e Projektit dhe me kërkesën e Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Disbursimet do të bëhen në përputhje me grafikun e disbursimit të parashikuar në shtojcën 1 (*Grafiku i Disbursimit*) të kësaj Marrëveshjeje Huaje. KfW-ja do të kryejë disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo periudhë disbursimi të specifikuara në shtojcën 1. Kur Agjencia e Zbatimit të Projektit kërkon disbursime për shuma më të vogla brenda çdo periudhe të tillë, shumat e padisbursuara mund të kërkohen në çdo periudhë pasuese. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disbursime në një shumë më të vogël se 200.000,00 euro.

3.2 *Afati për kërkimin e disbursimeve.* KfW-ja gëzon të drejtën t'i refuzojë disbursimet pas datës **30 qershor 2028**.

3.3 *Kushtet paraprake të disbursimit.* KfW-ja është e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm me përmbushjen e kushteve të mëposhtme paraprake në formë dhe përmbajtje të pranueshme për KfW-në:

a) Huamarrësi duhet t'i tregojë KfW-së, duke i paraqitur opinionin ligjor dhe kopje të certifikuara (secila prej tyre duhet të ketë përkthimin zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet ai konfirmim ligjor, se Marrëveshja e Huas është plotësisht efektive dhe e zbatueshme nga pikëpamja ligjore dhe duhet t'i vërtetojë në mënyrë të veçantë se:

i. Huamarrësi i ka përmbushur të gjitha kërkesat e së drejtës kushtetuese dhe dispozitat e tjera ligjore të zbatueshme që kanë të bëjnë me detyrimet e tij në kuadër të kësaj Marrëveshjeje; dhe se

ii. KfW-ja është përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi burim nga interesat, detyrimet, komisionet dhe kostot e ngjashme në Republikën e Shqipërisë gjatë dhënies së Huas;

b) Agjencia e Zbatimit të Projektit duhet t'i tregojë KfW-së, duke i paraqitur konfirmimin ligjor dhe kopje të certifikuara (secila prej tyre duhet të ketë përkthimin zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet ai opinion ligjor, se Agjencia e Zbatimit të Projektit është themeluar sipas rregullave dhe është plotësisht funksionale dhe se Marrëveshja e Huas është ekzekutuar si duhet nga Agjencia e Zbatimit të Projektit;

c) KfW-ja zotëron origjinalin e kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Veçantë, ku secila është nënshkruar ligjërisht;

d) modelet e nënshkrimeve të përmendura në nenin 13.2 (*Përfaqësimi i Agjencisë së Zbatimit* të Projektit) janë marrë nga KfW-ja;

e) garancia nga Republika Federale e Gjermanisë e përmendur në nenin 8 (*Garancia e Republikës Federale të Gjermanisë*) është në fuqi dhe efekt pa kufizim;

f) Huamarrësi e ka paguar tarifën e menaxhimit të përcaktuar në nenin 4.2 *(Tarifat e menaxhimit*);

g) nuk ka ndodhur asnjë arsye për zgjidhjen e Marrëveshjes, as ndonjë incident që do të përbënte shkak për zgjidhjen e Marrëveshjes me anë të njoftimit ose skadimit ose konstatimit apo plotësimit të një kushti (arsye e mundshme për zgjidhjen e Marrëveshjes); dhe

h) nuk kanë lindur rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

Para disbursimit nga Huaja, KfW-ja ka të drejtën të kërkojë dokumente dhe prova të tjera që i çmon të nevojshme sipas diskrecionit të saj për të konstatuar kushtet paraprake për disbursimin të përcaktuara në këtë seksion.

3.4 *Detaje të procedurës së disbursimit.* Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do t'i përcaktojnë detajet e procedurës së disbursimit me Marrëveshje të Veçantë, e cila do të lidhet siç lexohet dhe dakordësohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që përfaqëson Huamarrësin, veçanërisht provat që duhet të jepen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit të cilat dokumentojnë se shumat e Huas së kërkuar po përdoren për qëllimin e rënë dakord.

3.5 *E drejta për të anuluar disbursimet.* Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të tij sipas nenit 11 (*Detyrimet e veçanta*) Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumës së Huas së padisbursuar me pëlqimin paraprak të KfW-së kundrejt pagesës së **kompensimit të mospërdorimit** sipas dhe siç përkufizohet në nenin 3.6 (*Kompensimi i mospërdorimit*) të kësaj marrëveshjeje.

3.6 *Kompensimi i mospërdorimit.* Nëse Huamarrësi anulon disbursimin e një shume të Huas për të cilën një normë interesi është përcaktuar tashmë sipas nenit 3.5 (E drejta për anulimin e disbursimit) ose nëse shuma e kësaj Huaje nuk disbursohet aspak ose nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në nenin 3.2 (*Afati për kërkimin e disbursimeve*), Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, sipas kërkesës së saj, shumën që është e nevojshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar nga KfW-ja si rezultat i mosdisbursimit të shumës së Huas (*Kompensimi i mospërdorimit*), me përjashtim të rasteve kur mosdisbursimi përbën një shkelje të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja. KfW-ja e llogarit shumën e kompensimit të mospërdorimit dhe ia komunikon atë Huamarrësit. Kompensimi i mospërdorimit duhet përdorur njësoj sikur Republika Federale e Gjermanisë të mos ketë dhënë asnjë subvencion interesi për Projektin.

4. Tarifat

4.1 *Tarifa e zotimit financiar.* Huamarrësi paguan një tarifë të parimbursueshme të zotimit financiar prej 0.25% në vit (*Tarifa e zotimit financiar)* për shumën e padisbursuar të Huas.

Tarifa e zotimit bëhet e kërkueshme për pagesë çdo gjysmë viti në fund të periudhës 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, ku për herë të parë bëhet e kërkueshme më 15 maj 2023, por jo më parë se në datën përkatëse pas datës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi sipas nenit 15.11 (*Hyrja në fuqi dhe efekt*).

Tarifa e angazhimit do të faturohet nëse është me efekt prapaveprues për periudhën që fillon dymbëdhjetë muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të zgjasë deri në datën e disbursimit të plotë të Huas ose nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit të plotë të disbursimeve nga Huaja.

4.2 *Tarifa e menaxhimit.* Për menaxhimin, Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë të parimbursueshme dhe të pakthyeshme të barabartë me 1.00% të shumës së Huas së përcaktuar në nenin 1.1 (*Shuma*) (*Tarifa e menaxhimit*).

Tarifa e menaxhimit bëhet e pagueshme në datën më të hershme prej dy datave në vijim: i) para disbursimit të parë; ose ii) pas kalimit të tre muajve që prej nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja ose me kalimin e një periudhe njëmujore pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi dhe efekt (në varësi se cila nga datat e përcaktuara sipas pikës "ii" është më e vonshme). Tarifa e menaxhimit është e kërkueshme për pagesë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nëse Huaja është disbursuar plotësisht ose vetëm pjesërisht ose nëse nuk është disbursuar.

5. Interesi

5.1 *Norma fikse e interesit e përcaktuar për disbursimin e Huas*

a) *Norma e interesit.* Huamarrësi paguan interes për çdo shumë Huaje të disbursuar në normën (*Norma fikse e interesit*) e përcaktuar nga KfW-ja brenda dy **ditësh bankare** (siç përkufizohet në nenin 15.1 (*Dita bankare*)) përpara disbursimit të shumës përkatëse të Huas dhe ky interes përbëhet nga:

i) Norma e shkëmbimit e përcaktuar në bazë të faqes Reuters "**ICAPEURO**" ose, nëse kjo faqe nuk përmban detajet e nevojshme apo nuk është e aksesueshme, në faqen e Bloomberg "**ICAE**" (ose në një faqe tjetër që zëvendëson faqen e Bloomberg dhe Reuters të cituar më lart). Nëse asnjëra prej këtyre faqeve nuk i përmban të dhënat e nevojshme ose janë të paaksesueshme, KfW-ja e përcakton këtë normë në bazë të kostove efektive të financimit në tregun e kapitalit në euro për maturitete që përkojnë sa më shumë të jetë e mundur me periudhat përkatëse të normave të interesit,

ii) plus një marzh prej _0.55_% (shprehur në fjalë: _zero pikë pesëdhjetë e pesë_ për qind) që merr parasysh fondet e grantit të vëna në dispozicion nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Nëse norma e interesit e llogaritur në përputhje me sa më lart bie nën 0% në vit, norma fikse e interesit do të jetë 0 % në vit.

Kështu, norma fikse e interesit të përcaktuar do të zbatohet deri kur të jetë marrë edhe kësti i fundit i pagesës në përputhje me grafikun e pagesave të përcaktuar në nenin 6.1 *(Grafiku i shlyerjeve).*

b) *Konsolidimi.* Nëse nga Huaja është bërë më shumë se një disbursim, KfW-ja e konsolidon normën fikse të interesit për çdo shumë Huaje në një normë të vetme interesi pas çdo disbursimi. Norma e konsoliduar fikse e interesit përkon me mesataren e ponderuar të normave individuale të interesit të rrumbullakosura në 1/10,000 të një pikë përqindjeje nëse shifra e parë pas presjes është më e ulët se 5 ose e rrumbullakosur në 1/10,000 të një pikë përqindjeje nëse shifra e parë pas presjes është e barabartë ose më e madhe se 5, dhe kjo do të shërbejë si bazë për llogaritjet e ardhshme të normës së interesit nga data e çdo disbursimi deri në disbursimin tjetër. Pas disbursimit të plotë të Huas, norma e përcaktuar mesatare fikse e interesit do të zbatohet deri kur të jetë marrë edhe kësti i fundit i pagesës në përputhje me grafikun e pagesave të përcaktuar në nenin 6.1 (*Grafiku i shlyerjeve*).

c) *Njoftimi i normës së interesit*. KfW-ja e njofton Huamarrësin pa vonesë për normën fikse të interesit sipas nenit 5.1 a) (*Norma e interesit*) menjëherë pasi kjo normë të jetë përcaktuar. KfW-ja e njofton Huamarrësin për normën e konsoliduar të interesit sipas nenit 5.1 b) (*Konsolidimi*) përpara datës së ardhshme të pagesës (siç përcaktohet në nenin 5.3 (*Datat e pagesës*).

5.2 *Llogaritja e interesit.* Interesi për një shumë të disbursuar të Huas do të faturohet nga data (duke e përjashtuar) në të cilën shuma përkatëse e Huas disbursohet nga llogaria e Huas që mbahet te KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë) në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së të përcaktuar këtu në nenin 7.3 (*Numri i llogarisë, koha e kreditimit*). Interesi do të llogaritet në pajtim me nenin 7.1 (*Llogaritja*).

5.3 *Datat e pagesës.* Interesi do të jetë i kërkueshëm në shuma të prapambetura për pagesë në datat e përcaktuara **më poshtë (secila e referuar si "Datë pagese"**):

a) para datës së kërkueshme të kështit të shlyerjes së parë, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, por jo më parë se në datën e pagesës pas datës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt në bazë të nenit 15.11 *(Hyrja në fuqi dhe në efekt)*;

b) në datën e kërkueshme të kështit të shlyerjes së parë në bazë të nenit 6.1 (*Grafiku i shlyerjes*) së bashku me këtë këst;

c) më pas, në datat e kërkueshme të kësteve të shlyerjes në bazë të nenit 6.1 (*Grafiku i shlyerjes*).

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 *Grafiku i shlyerjes.* Huamarrësi do ta shlyejë Huan si më poshtë:

	Data e kërkueshme	Kësti i shlyerjes	
1	15 maj 2028	952,380.95	EURO
2	15 nëntor 2028	952,380.95	EURO
3	15 maj 2029	952,380.95	EURO
4	15 nëntor 2029	952,380.95	EURO
5	15 maj 2030	952,380.95	EURO
6	15 nëntor 2030	952,380.95	EURO
7	15 maj 2031	952,380.95	EURO
8	15 nëntor 2031	952,380.95	EURO
9	15 maj 2032	952,380.95	EURO
10	15 nëntor 2032	952,380.95	EURO
11	15 maj 2033	952,380.95	EURO
12	15 nëntor 2033	952,380.95	EURO
13	15 maj 2034	952,380.95	EURO
14	15 nëntor 2034	952,380.95	EURO
15	15 maj 2035	952,380.95	EURO
16	15 nëntor 2035	952,380.95	EURO
17	15 maj 2036	952,380.95	EURO
18	15 nëntor 2036	952,380.95	EURO
19	15 maj 2037	952,380.95	EURO
20	15 nëntor 2037	952,380.95	EURO
21	15 maj 2038	952,381.00	EURO

Ky grafik pagese mund të përshtatet herë pas here në përputhje me nenin 6.5 (*Grafiku i rishikuar i pagesave*).

6.2 *Shumat e padisbursuara të Huas.* Shumat e padisbursuara të Huas do të kompensohen kundrejt kështit përkatës të fundit të shlyerjes në pajtim me grafikun e shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1 (*Grafiku i shlyerjes*) përveç kur KfW-ja, sipas diskrecionit të saj, zgjedh një alternativë tjetër kompensimi në raste të veçanta.

6.3 *Shlyerjet në rast të disbursimit të paplotë.* Nëse një këst shlyerjeje është i kërkueshëm para disbursimit të plotë të Huas, kjo nuk do të cenojë grafikun e shlyerjes, në bazë të nenit 6.1 (*Grafiku i shlyerjes*) për sa kohë që kësti i shlyerjes i kërkueshëm në pajtim me grafikun e shlyerjes është më i vogël se shuma e Huas e disbursuar dhe ende i pashlyer (*Shuma e papaguar e Huas*). Nëse kësti i shlyerjes i kërkueshëm në pajtim me nenin 6.1 (*Grafiku i shlyerjes*) tejkalon shumën e papaguar të Huas, ky këst shlyerjeje do të ulet në nivelin e shumës së papaguar të huas dhe diferenca do të shpërndahet në mënyrë të barabartë për kështet e shlyerjes ende të papaguara. Në llogaritjen e shumës së papaguar të huas, KfW-ja rezervon të drejtën për të shqyrtuar disbursimet nga Huaja që kryhen brenda një periudhe prej 45 ditësh ose disa ditë para një date pagese për përcaktimin e shumës së papaguar të huas, vetëm për datën e ardhshme pasuese të pagesës.

6.4 *Parapagesat*. Për parapagesat gjejnë zbatim sa më poshtë:

a) *E drejta e parapagimit.* Huamarrësi, në pajtim me pikat e mëposhtme 6.4 b) (*Njoftimi*) deri te 6.4 e) (*Kompensimi*) ka të drejtë të shlyejë shuma Huaje para datës së kërkueshme të planifikuar nëse ky parapagim është të paktën në shumën e një kësti shlyerjeje në pajtim me nenin 6.1 (*Grafiku i shlyerjes*).

b) *Njoftimi.* Një parapagim i një shume Huaje në pajtim me nenin 6.4 a) (*E drejta për parapagim*) i nënshtrohet një njoftimi parapagimi nga Huamarrësi drejtuar KfW-së, jo më vonë se Dita Bankare e pesëmbëdhjetë para datës së synuar të parapagimit. Ky njoftim është i pakthyeshëm dhe duhet të përcaktojë datën dhe shumën e parapagimit, si dhe e detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e përcaktuar.

c) *Tarifa e parapagimit.* Nëse Huamarrësi parapaguan një shumë Huaje me interes fiks, Huamarrësi i paguan menjëherë KfW-së me kërkesë të saj shumën e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto që i është shkaktuar KfW-së si rezultat i kësaj parapagese (*Tarifa e parapagesës*). KfW-ja e përcakton shumën e tarifës së parapagimit dhe ia komunikon atë Huamarrësit. Tarifa e **parapagesës** duhet përdorur njësoj sikur Republika Federale e Gjermanisë të mos ketë dhënë asnjë subvencion interesi për Projektin. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një të dhënë të shumës së tarifës së parapagimit para njoftimit të kërkuar të parevokueshëm për shlyerjen në bazë të nenit 6.4 b) *(Njoftimi).*

d) *Shumat e kërkueshme.* Së bashku me parapagimin në pajtim me nenin 6.4 a) (*E drejta për parapagim*), Huamarrësi do të paguajë shumat e mëposhtme:

i) çdo tarifë parapagimi e kërkueshme si rezultat i parapagimit sipas nenit 6.4 c) (*Tarifa e parapagimit*); dhe

ii) të gjithë interesin e mbledhur për shumën e Huas së parapaguar dhe çdo pagesë tjetër që është

ende e pashlyer në kuadër të kësaj Marrëveshjeje që është mbledhur deri në datën e parapagesës.

e) *Kompensimi*. Neni 6.2 (*Shumat e padisbursuara të Huas*) zbatohet *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimeve.

6.5 *Grafiku i rishikuar i shlyerjeve*. Në rastin kur zbatohet neni 6.3 (*Shlyerjet në rast të disbursimit të paplotë*) ose neni 6.4 (*Parapagimi*), KfW-ja do t'i dërgojë Huamarrësit një grafik të rishikuar shlyerjeje që do të bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 *Llogaritja*. Interesi, tarifa e zotimit financiar, kamatëvonesa sipas nenit 7.5 (*Kamatëvonesa*), kompensimi si një këst i vetëm për shumat e vonuara sipas nenit 7.6 (*Kompensimi me shumë të plotë*), kompensimi i mospranimit dhe tarifa e parapagimit llogariten në bazë të vitit kalendarik prej 360 ditësh me muaj me nga 30 ditë.

7.2 *Data e kërkueshme*. Nëse një pagesë që duhet të kryhet në lidhje me këtë Marrëveshje bëhet e kërkueshme në një datë që nuk është ditë bankare, Huamarrësi duhet ta kryejë këtë pagesë në ditën bankare pasuese. Nëse data e ardhshme Bankare bie brenda muajit të ardhshëm kalendarik, kjo pagesë bëhet në datën e fundit bankare të muajit kalendar aktual.

7.3 *Numri i llogarisë, koha e kreditimit*. Huamarrësi do të lirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje, nëse dhe deri në masën që shumat përkatëse do t'i jenë kredituar KfW-së në disponim të saj të lirë pa asnjë zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10:00 paradite në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, në llogarinë e KfW-së në Frankfurt am Main, Republika e Gjermanisë, numër IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01 që përcakton datën e kërkueshme si referencë shtesë ("Ref. YYYYMMDD").

7.4 *Kundërpretendimet e Huamarrësit*. Huamarrësi nuk ka të drejtë të ngrejë asnjë pretendim mbajtjeje ose kompensimi apo të drejta të ngjashme ndaj detyrimeve për pagesa sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse këto të drejta nuk njihen nga një gjykim deklarues ose nuk miratohen nga KfW-ja.

7.5 *Kamatëvonesa*. Nëse ndonjë këst shlyerjeje ose parapagim në pajtim me nenin 6.4 (Parapagimi) nuk janë në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të caktojë kamatëvonesë në normën prej 200 pikësh bazë mbi normën e interesit në vit të përcaktuar në nenin 5 (*Interesi*) për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën në të cilën këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 7.3 (*Numri i llogarisë, koha e kreditimit*). Kjo kamatëvonesë duhet paguar menjëherë pas kërkesës së parë të KfW-së.

7.6 *Kompensimi me shumë të plotë*. Për shumat e prapambetura (me përjashtim të kësteve të shlyerjeve dhe të parapagimeve të përmendura në nenin 7.5 (*Interes i papaguar*), KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë kompensim në shumë të plotë nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës me një normë prej 200 pikësh bazë në vit mbi normën fikse të interesit në bazë të nenit 5 (*Interesi*). Kompensimi me shumë të plotë duhet paguar menjëherë pas kërkesës së parë të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të tregojë se nuk ka pasur asnjë dëmtim ose që dëmtimet ishin më të vogla se kompensimi me shumë të plotë.

7.7 *Kompensimi*. KfW-ja gëzon të drejtën e kompensimit të pagesave të marra kundrejt pagesave të kërkueshme në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe në kuadër të marrëveshjeve të tjera të Huas të lidhura midis KfW-së dhe Huamarrësit.

7.8 *Llogaritë e bëra nga KfW-ja*. Në mungesë të gabimeve të dukshme, vlerat e llogaritura nga KfW-ja dhe llogaritjet e kryera nga KfW-ja të shumave të kërkueshme në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje përbëjnë të dhëna provuese *prima-facie* (*Anscheinsbeweis*).

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja merr garanci për pretendimet e pagesës në kuadër të kësaj Marrëveshjeje nga Republika Federale e Gjermanisë përpara disbursimit të parë.

9. Paligjshmëria

Nëse në çdo juridiksion të zbatueshëm bëhet e paligjshme për KfW-në për të kryer ndonjë prej detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Marrëveshje ose për të financuar ose mbajtur Huan, KfW-ja njofton Huamarrësin, se:

a) Zotimi financiar i KfW-së do të anulohet menjëherë; dhe

b) Huamarrësi do të paguajë vetëm shumat e disbursuara dhe që nuk janë shlyer ende në datën e përcaktuar nga KfW-ja në njoftimin e dërguar për Huamarrësin (jo më parë se ditën e fundit të çdo

periudhe lehtësuese të zbatueshme, të lejuar me ligj).

Për të shmangur çdo dyshim, çdo anulim do të jetë subjekt i nenit 3.6 *(Tarifa e mospërdorimit)* dhe çdo pagesë e Huas përbën parapagim dhe do të jetë subjekt i dispozitave të përcaktuara në nenin 6.4 c) (*Tarifa e parapagimit*) dhe d) (*Shumat e kërkueshme*).

10. Kostot dhe tarifat publike

10.1 *Ndalimi i zbritjeve ose i mbajtjeve.* Huamarrësi kryen të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje pa asnjë zbritje për taksat, detyrimet e tjera publike ose kosto të tjera. Në rast se Huamarrësi është i detyruar me ligj ose nga shkaqe të tjera që t'i kryejë këto zbritje ose mbajtjet për pagesat, Huamarrësi paguan çdo shumë shtesë të nevojshme në mënyrë që KfW-ja të marrë në mënyrë të plotë të gjitha shumat e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje pas zbritjes së taksave dhe tarifave.

10.2 *Kostot.* Huamarrësi do të mbulojë të gjitha shpenzimet dhe kostot që shkaktohen në lidhje me disbursimin dhe shlyerjen e Huas, veçanërisht kostot e remitancave dhe transferimit (duke përfshirë tarifat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që shkaktohen në lidhje me mbajtjen ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me këtë Marrëveshje, si dhe të drejtave që burojnë prej saj.

10.3 *Taksa dhe detyrime të tjera.* Huamarrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë mbi lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje. Nëse KfW-ja parapaguan këto taksa ose detyrime, Huamarrësi do t'i transferojë ato pa vonesë, me kërkesë, në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3 (*Numri i llogarisë, koha e kreditimit*) ose në ndonjë llogari tjetër të përcaktuar nga KfW-ja.

11. Detyrime të veçanta

11.1 *Zbatimi i programit dhe informacioni specifik.* Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) do të përgatitë, zbatojë, operojë dhe ruajë Projektin në pajtim me praktikat e qëndrueshme financiare dhe teknike, në pajtim me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në pajtim me konceptin e Projektit të rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe KfW-së;

b) do t'ia caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të kualifikuar, të pavarur dhe zbatimin e Projektit për firma të kualifikuara;

c) përmbush kurdoherë dispozitat e prokurimit të parashikuara në Marrëveshjen e Veçantë duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe të regjistrave që tregojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

e) do t'i japë mundësinë, në çdo kohë, KfW-së dhe agjentëve të saj që të inspektojnë ata libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër të lidhur me zbatimin dhe operimin e Projektit, si dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet e lidhura me të; dhe

f) do t'i japë KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhënat mbi Projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm që KfW-ja mund të kërkojë;

11.2 *Detaje të Zbatimit të Projektit.* Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë që lidhen me nenin 11.1 (Zbatimi i Projektit dhe informacioni specifik) me anë të Marrëveshjes së Veçantë, e cila do të nënshkruhet siç është lexuar dhe rënë dakord nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që përfaqëson Huamarrësin.

11.3 *Detyrime të përbashkëta lidhur me projektin.* Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projekteve

a) do të garantojnë financimin e plotë të Projektit dhe do t'i japin KfW-së, sipas kërkesës, të dhëna që provojnë se kostot e papaguara nga kjo Hua janë mbuluar;

b) menjëherë dhe me iniciativën e vet;

i) do të njoftojë KfW-në për të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit;

ii) do t'i paraqesë KfW-së çdo pyetje të marrë nga Huamarrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit nga OECD-ja ose anëtarët e tij, sipas të ashtuquajturës "Marrëveshje për transparencën e kredive ODA të bashkuara" pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja dhe do të koordinojë përgjigjet e këtyre pyetjeve me KfW-në.

11.4 *Detyrimet e Huamarrësit lidhur me Projektin.* Huamarrësi, do ta mbështesë Agjencinë e Zbatimit të Projektit për zbatimin e Projektit dhe përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, do t'i japë Agjencisë

së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit.

11.5 *Sigurimi i përputhshmërisë.* Huamarrësi merr përsipër të zbatojë kurdoherë detyrimet e parashtruara në shtojcën 2a (*Zotimet e përpuethshmërisë së Huamarrësit*). Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 2b (A*kti i përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit*).

11.6 *Transporti i furnizimeve.* Dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen Qeveritare që janë të njohura për Huamarrësin zbatohen për transportin e mallrave që financohen nga Huaja.

11.7. *Renditja Pari passu.* Huamarrësi garanton dhe merr përsipër të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe do të marrë shërbime në të njëjtin rang prioriteti (*pari-passu*) me të gjitha borxhet e jashtme të pasiguruara dhe jo të varura, dhe Huamarrësi do të sigurojë në masën e lejuar nga ligji se kjo renditje do të sigurohet për të gjitha borxhet e tjera të jashtme të ardhshme të pasiguruara dhe jo të varura. Në këtë Marrëveshje, "**Borxh i jashtëm**" nënkupton një detyrim të Huamarrësit, i cili:

i) rregullohet nga një sistem ligjesh krahas ligjeve të Huamarrësit; ose

ii) paguhet në një monedhë të ndryshme nga monedha e vendit të Huamarrësit; ose

iii) i paguhet një personi që është i përfshirë, jeton, është banor, ka selinë ose zyrat qendrore të biznesit jashtë territorit të vendit të Huamarrësit.

12. Zgjidhja e Marrëveshjes

12.1 *Arsyet e zgjidhjes.* KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara në nenin 12.2 (*Pasojat ligjore të ndodhjes së një arsyeje për zgjidhjen e Marrëveshjes*) nëse lind një rrethanë që përbën shkak të rëndësishëm (*Wichtiger Grund*). Këtu përfshihen në veçanti ngjarjet e mëposhtme:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes Shoqëruese të Grantit apo Marrëveshjes së Veçantë, si dhe sipas marrëveshjeve të tjera shtesë që janë të detyrueshme ligjërisht në lidhje me këtë Marrëveshje, janë shkelur;

c) kjo Marrëveshje ose ndonjë pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyrues ndaj Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit ose nuk mund të jetë më e zbatueshme ndaj Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit;

d) çdo deklaratë, konfirmim, informacion, përfaqësim apo garanci e konsideruar nga KfW-ja si thelbësore për dhënien dhe ruajtjen e Huas, rezulton e rreme, e gabuar dhe e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje;

f) Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se shumat e Huas janë përdorur për qëllimin e caktuar;

g) Huamarrësi nuk është më në gjendje të vazhdojë kryerjen e pagesave ndaj kreditorëve, nuk ka aftësi paguese ose fillon bisedimet me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit për një moratorium, heqjen dorë nga borxhet e mbetura, ose zgjidhjen apo mosvazhdimin e shërbimit të borxhit.

12.2 *Pasojat ligjore të ndodhjes së arsyes për përfundim.* Nëse ka ndodhur një prej rasteve të përmendura në nenin 12.1 (*Arsyet për përfundim*), KfW-ja mund t'i pezullojë menjëherë disbursimet sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse ky rast nuk është zgjidhur brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 12.1 a) ose në të gjitha rastet e tjera të specifikuara në nenin 12.1 a) (*Arsyet për përfundim*), brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja që gjithsesi duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të zgjidhë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, me pasojën e heqjes së detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të plotë ose të pjesshme të shumës së papaguar të Huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje. Nenet 7.5 (*Interes i papaguar*) dhe 7.6 (*Kompensimi me shumë të plotë*) zbatohen për shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis.*

12.3. *Kompensimi për dëmet.* Në rast se kjo Marrëveshje zgjidhet plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi paguan kompensimin për mospranimin sipas nenit 3.6 (*Kompensimi i mospërdorimit*) dhe/ose kompensimi i pagimit të parakohshëm në pajtim me nenin 6.4c) *(Tarifa e parapagesës).*

13. Përfaqësimet dhe deklaratat

13.1 *Përfaqësimi i Huamarrësit.* Ministri i Financave dhe Ekonomisë e përfaqëson Huamarrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

13.2 *Përfaqësimi i Agjencisë së Zbatimit të Projektit*. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me anë të modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në zbatimin e Projektit dhe ushtrimin e të drejtave në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të përfundojë nëse nuk është marrë nga KfW-ja. Revokimi i saj i shprehur nga përfaqësuesi i Agjencisë së Zbatimit të Projektit të autorizuar në atë kohë,

13.3 *Adresat*. Njoftimet dhe deklaratat në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen si kopje origjinale ose, me përjashtim të kërkesave për disbursime, me faks. Çdo njoftim dhe të gjitha njoftimet ose deklarimet e bëra në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Faks: +49 69 7431-2944

Për Huamarrësin: Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Blvd. "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
1001 Tiranë, Shqipëri

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit: Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga "Sami Frashëri", nr. 10
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4234 885
Faks: +355 4234 885

14. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Projektin

14.1 *Publikimi i informacioneve lidhur me projektin nga KfW-ja*. Për të përmbushur parimet e pranuara në rang ndërkombëtar për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja e bën publik informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post*) për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me Projektin dhe me fazën paskontraktuale (në vijim referuar si "**Periudha e plotë**").

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e Bankës për Zhvillim KfW (https://www.kfw.de/microsites/Microsite/transparenz.kfw.de/#/start).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja, ose palët e treta në pajtim me nenin 14.3 (*Transferim i informacioneve lidhur me projektin te palët e treta dhe publikimi i tyre*) më poshtë), në lidhje me Projektin dhe financimin e tij nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose ndonjë informacion të detajuar delikat financiar ose biznesi në lidhje me palët e përfshira në Projekt ose financimin e tij, të tilla si:

a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;

b) strategji biznesi;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme;

d) të dhëna personale të personave fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

14.2 *Transferimi i informacionit të lidhur me Projektin te palët e treta*. KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) Degët e KfW-së;

b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë apo subjektet kompetente;

c) Organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin e zhvillimit dypalësh gjerman, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) Organizatat ndërkombëtare të angazhuara në mbledhjen e të dhënave statistikore, dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Agjencia e Zbatimit të Projektit

14.3 *Transferim i informacioneve lidhur me projektin te palët e treta dhe publikimi i tyre*. Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit përgjatë periudhës së plotë me subjektet e mëposhtme, që botojnë artikuj që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Nismës Ndërkombëtare për Transparenë të

Ndihmës (https://www.bmz.de/en/ministry/facts-figures/project-and-organisation-data);

b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun (http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/welcome.html);

c) OECD për qëllimin e raportimit të rrjedhës financiare në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit (https://www.oecd.org/);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllime të zhvillimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për të garantuar transparencën dhe eficiencën (https://www.deval.org/en/).

14.4 *Transferim i informacioneve lidhur me projektin te palët e treta (përfshirë publikimin e tyre).* KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë periudhës së plotë te palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit në informacionin që nuk transferohet i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit, në veçanti përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve delikate të përmendura në nenin 14.1 (*Publikimi i informacioneve lidhur me projektin nga KfW-ja*), i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion për palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregulloreve, ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

15. Dispozita të përgjithshme

15.1 *Ditë bankare.* Është çdo ditë (përveç të shtunës dhe të dielës) në të cilën bankat tregtare janë hapur për punë në Frankfurt am Main, Gjermani, me kusht që, për të përcaktuar datën e shlyerjes dhe datën e pagesës në lidhje me Huan e parashikuar këtu dhe për të përcaktuar datat e disbursimit apo të pagesave të tjera, kjo ditë duhet të jetë edhe ditë e synuar.

Dita e synuar. Është çdo ditë në të cilën sistemi i automatizuar transevropian për transferimet ekspres të likuidimit bruto (TARGET) është i hapur për likuidimin e pagesave në euro.

15.2 *Vendi i ekzekutimit të marrëveshjes.* Vendi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje është Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë**.**

15.3 *Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet.* Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, ose nëse ekziston një boshllëk në një prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitave të tjera. Palët e kësaj Marrëveshjeje e zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë ligjërisht të vlefshme që i afrohet sa më shumë që të jetë e mundur frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët plotësojnë çdo boshllëk në dispozita me një dispozitë ligjërisht të vlefshme që i afrohet frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

15.4 *Forma e shkruar.* Çdo shtesë ose ndryshim i kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë e formës me shkrim duhet të deklarohet nga palët me shkrim.

15.5 *Ndryshimet.* Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit nuk kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim të kësaj Marrëveshjeje, i cili përpara nënshkrimit duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk do të kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave.

15.6 Transferimi i të drejtave. As Huamarrësi, as Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të delegojnë ose transferojnë, rëndojnë me peng ose hipotekë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje Huaje.

15.7 Ligji i zbatuar. Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji gjerman.

15.8 Afati i kufizimit. Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje mbarojnë pesë vjet nga fundi i vitit në të cilin kanë lindur këto të drejta dhe në të cilin KfW-ja është vënë në dijeni të rrethanave që përbëjnë këtë pretendim ose mund të ishte vënë në dijeni pa neglizhencë flagrante.

15.9 Heqja dorë nga imuniteti. Në masën që Huamarrësi, aktualisht ose në të ardhmen, në një juridiksion mund të pretendojë për vete ose sendet e tij pasurore, imunitet nga padia, ekzekutimi,

sekuestrimi ose një proces tjetër ligjor dhe në masën që Huamarrësi, në mënyrë të pakthyeshme, heq dorë nga ky imunitet për pretendime nga dhe në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje në masën më të gjerë të lejuar nga ligji i këtij juridiksioni.

Me përjashtim të disa rasteve, Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet në lidhje me ekzekutimin e ndonjë vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i) "mjediset e misionit" të tashme ose të ardhshme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike nënshkruar në vitin 1961, "mjediset konsullore" të tashme ose të ardhme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në vitin 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik në Shqipëri;

ii) çdo pasuri e paluajtshme që përfshihet në dispozitat e nenit 3, paragrafi 1–3 i ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001, "Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore";

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë sipas traktateve ndërkombëtare të së drejtës publike, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj;

iv) çdo fond ose aset i destinuar për qëllime publike në përputhje me dispozitat e detyrueshme në fuqi të ligjeve ndërkombëtare dhe ligjeve të huaja.

15.10 Mosmarrëveshjet ligjore

Arbitrazhi. Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë aspekt, zbatohen sa më poshtë:

i) Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) që ndryshohet herë pas here;

ii) Gjykimet në arbitrazh kryhen në Frankfurt am Main. Gjykimet zhvillohen në gjuhën angleze.

15.11 Hyrja në fuqi. Kjo Marrëveshje Huaje hyn në fuqi jo më parë se Huamarrësi të ketë informuar KfW-në me shkrim që procedurat e brendshme ligjore që Huamarrësi duhej të përmbushte, janë plotësuar (data e marrjes në dorëzim nga KfW-ja). KfW-ja do të informojë Huamarrësin për marrjen në dorëzim.

Në rast se Marrëveshja e Huas nuk ka hyrë në fuqi pas gjashtë muajsh pas datës së nënshkrimit të saj, ose pas kalimit të afateve të tjera të rëna dakord nga KfW-ja, deri në datën e hyrjes në fuqi, KfW-ja do të ketë të drejtën të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga kjo Marrëveshje Huaje dhe të përfundojë pezullimin e saj duke i dërguar Huamarrësit një njoftim me shkrim.

Hartuar në 3 (tri) kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt mbi Main, 29 dhjetor 2022

KfW

_____

Emri: Arne Goss
Titulli: Shefi Departamentit Infrastruktura Bashkiake Evropa Juglindore & Turqia

_____

Emri: Brit Horschke
Titulli: Drejtori i vendit për Shqipërinë i KfW

Tiranë, _____

Republika e Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

_____

Emri: Delina Ibrahimaj

Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

_____

Emri: Dritan Agolli
Titulli: Drejtor ekzekutiv

SHTOJCA 1
GRAFIKU I DISBURSIMIT

Grafiku më i shpejtë i mundshëm i disbursimit

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi (*Data efektive e përfundimit të periudhës* në përputhje me listën e mëposhtme), Huamarrësi mund të kërkojë disbursime deri në një masë që nuk tejkalon shumën kumulative të disbursimeve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

Periudha	**Data efektive e fillimit të periudhës (përfshirë)**	**Data efektive e përfundimit të periudhës (përjashtuar)**	**Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (kumulative)** (të gjitha shifrat në euro)
1	1.1.2023	1.7.2023	1,000,000.00
2	1.7.2023	1.1.2024	3,000,000.00
3	1.1.2024	1.7.2024	8,000,000.00
4	1.7.2024	1.1.2025	16,000,000.00
5	1.1.2025	1.7.2028	20,000,000.00

SHTOJCA 2A
ZOTIMET E PAJTUESHMËRISË SË HUAMARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

Praktika shtrënguese: është dëmi ose dëmtimi, ose kërcënimi për t'i bërë dëm ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo personi ose pasurie të personit, me qëllim që të ndikojë në mënyrë të parregullt në veprimet e një personi.

Praktikë e fshehtë: është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e hartuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e gabuar të veprimeve të një personi tjetër.

Praktikë korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi i papërshtatshëm i çdo natyre, ndonjë personi ose nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e ndonjë personi ose që shkaktojnë që ndonjë person të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar.

Praktikë mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose synon të mashtrojë një person për të marrë përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Praktikë penguese: i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë të korruptuar, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i çdo pale për të parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii) veprime me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike të korruptuar, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

Person: çdo person fizik, person juridik, ortakëri ose shoqatë e pathemeluar.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (siç janë përcaktuar në këtë Marrëveshje), e cila: i) është e paligjshme sipas ligjit gjerman ose ndonjë ligji tjetër të zbatueshëm; dhe ii) ka ose mund të ketë një efekt material ligjor ose reputacional në Marrëveshjen ndërmjet Huamarrësit, dhe KfW-së ose në zbatimin e saj.

Sanksione: ligjet, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

Organ sanksionues: cilido nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuara posaçërisht, të cilat janë objekt i sanksioneve të lëshuara nga ndonjë organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJET PËR INFORMIM

Huamarrësi:

a) do të vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së me kërkesën "njih klientin tënd" përkatës ose informacione të ngjashme në lidhje me Huamarrësin, siç mund të kërkohet nga KfW-ja;

b) t'i paraqesë menjëherë KfW-së, me kërkesë, të gjitha informacionet dhe dokumentet e lidhura me Huamarrësin dhe kontraktorët (nënkontraktorët) e saj dhe palëve të tjera të lidhura që KfW-ja kërkon të përmbushë detyrimet e saj për të parandaluar praktikat e sanksionueshme, pastrimin e parave ose/dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Huamarrësin, të nevojshme për këtë qëllim;

c) informon menjëherë KfW-në dhe me pëlqimin e vet, sapo të njihet ose dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, veprim të pastrimit të parave dhe/ose financim të terrorizmit që lidhet me Projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj inspektimin në çdo kohë të dokumentacionit të Huamarrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktore apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave për Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. DEKLARIMI DHE GARANCIA

Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të Huamarrësit, Huamarrësi pretendon se asnjë person që vepron në emër të Huamarrësit me Projektin, nuk ka kryer ose kryen praktika të sanksionueshme, pastrim parash ose financim terrorizmi.

Deklarimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen bëhet për herë të parë nëpërmjet ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje. Do të konsiderohet të përsëritet pas çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë të pagesës së interesit, në secilin rast duke iu referuar rrethanave që mbizotërojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJE POZITIVE

Huamarrësi merr përsipër, menjëherë pasi Huamarrësi ose KfW-ja vihen në dijeni ose dyshojnë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, veprim të pastrimit të parave ose financim të terrorizmit, që të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të konstatuar nëse ka ndodhur një incident i tillë i pajtueshmërisë. Huamarrësi, në veçanti, do të përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme për çdo njoftim nga KfW-ja dhe do të ofrojë mbështetje të dokumentuar për përgjigjen e tillë sipas kërkesës së KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Huamarrësi nuk futet në transaksione ose angazhohet në veprimtari të tjera në lidhje me Projektin që mund të përbëjnë shkelje të sanksioneve.

SHTOJCA 2B
ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË SË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTIT

1. PËRKUFIZIME

Praktika shtrënguese: është dëmi ose dëmtimi, ose kërcënimi për t'i bërë dëm ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo personi ose pasurie të personit, me qëllim që të ndikojë në mënyrë të parregullt në veprimet e një personi.

Praktikë e fshehtë: është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

Praktikë korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi i papërshtatshëm i çdo natyre, ndonjë personi ose nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e ndonjë personi ose që shkaktojnë që ndonjë person të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar.

Kategoritë e përcaktuara të shkeljeve: kategoritë e mëposhtme të shkeljeve, të përkufizuara sipas rekomandimeve të FATF-së dhe shënimeve përkatëse interpretuese: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhur dhe mallrave të tjerë; korrupsioni dhe mitëmarrja/mitëdhënia; mashtrimi; falsifikimi i parave; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja me forcë

dhe pengmarrja; grabitja dhe vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat e tarifat doganore dhe akcizat); krimet tatimore (lidhur me taksat direkte dhe indirekte); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

Rekomandimet e FATF-së: këto rekomandime, siç përkufizohen herë pas here nga Grupi i Posaçëm për Veprimin Financiar (FATF). FATF është një organ ndërqeveritar, qëllimi i të cilit është zhvillimi dhe promovimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Praktikë mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose synon të mashtrojë një person për të marrë përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Burim i paligjshëm: burimi i fondeve të siguruara përmes

a) shkeljeve të renditura në kategorinë e përcaktuar të shkeljeve;

b) çdo praktikë korruptive;

c) çdo praktikë mashtruese; ose

d) pastrimit të parave.

Praktikë penguese: i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë të korruptuar, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i çdo pale për të parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii) veprime me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike të korruptuar, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

Person: çdo person fizik, person juridik, ortakëri ose shoqatë e pathemeluar.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë kanosëse, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese, ose praktike penguese (sipas termave të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i) është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii) ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose të lidhur me reputacionin mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së, apo zbatimi të saj.

Sanksione: ligjet, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

Organ sanksionues: cilido nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuara posaçërisht, të cilat janë objekt i sanksioneve të lëshuara nga ndonjë organ sanksionues.

2. NDËRMARRJA E INFORMACIONIT

Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) i vë në dispozicion KfW-së në kohë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që ka të bëjë me njohjen e klientit, apo informacione të ngjashme për Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe aksionarët (të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë), filialet dhe/ose ortakët e tjerë të saj (nëse ka);

b) i ofron KfW-së në kohë, sipas kërkesës, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të gjithë informacionin dhe dokumentet mbi Projektin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktore, apo palëve të tjera përkatëse, te të cilat KfW-ja mbështetet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave, dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon menjëherë dhe me iniciativën e saj, sapo merr dijeni, ose ka dyshime, KfW-në për çdo praktikë të sanksionueshme, pastrim parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj menaxheriale, drejtuese ose aksionerët e saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj Shtojce; dhe

e) i jep mundësinë KfW-së dhe agjentëve të tij të inspektojnë kurdoherë të gjithë dokumentacionin e lidhur me Projektin të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe (nën)kontraktorëve të saj dhe palëve të lidhura, dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse për qëllimet e kësaj shtojce;

f) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e saj për çdo ngjarje që mund të sjellë klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse, apo të aksionarëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë, ose persona apo subjekte të bllokuara, të renditur në çfarëdo lloj liste sanksionesh.

3. DEKLARIME DHE GARANCI

3.1 Në përputhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të regjistrimit ligjor të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, Agjencia e Zbatimit të Projektit përfaqëson dhe garanton vërtetësinë dhe saktësinë e të mëposhtmeve:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emër të saj dhe për llogari të vet;

b) Në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionarët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe as fondet e investuara në Projekt nuk kanë burim të paligjshëm;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, ortakët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash, apo financim të terrorizmit;

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk: i) ka lidhur ndonjë marrëdhënie pune me shtetas me emërtim të veçantë, apo persona dhe subjekte të bllokuara, të renditur në çfarëdo lloj liste sanksionesh; ose nuk ii) është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

3.2 Deklarimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të duhet të përsëriten në çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë pagese të interesit, gjithmonë referuar rrethanave mbizotëruese të asaj dite.

4. SIPËRMARRJE POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa asnjë kufizim kujdesin ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash, apo financim të terrorizmit, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputh-shmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet në kohë dhe hollësisht çdo njoftimi të KfW-së në veçanti dhe ofron mbështetje në dokumente për këtë përgjigje me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) të garantojë që kapitali dhe fondet e tjera që investon të mos jenë të një origjine të jashtëligjshme;

b) sigurojë se proceset e saj të punës nuk lënë vend për praktika të sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit; dhe

c) të mos lidhë apo të mos çojë më tej asnjë marrëdhënie pune me shtetas me emërtim të veçantë, apo persona dhe subjekte të bllokuara, të renditur në çdo listë sanksionesh; ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

DEKRET
Nr. 79, datë 8.6.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 31/2023, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW-së, Frankfurt Am Main (KfW), e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), (Agjencia e Zbatimit të Projektit) për projektin 'Zhvillimi i integruar rajonal"'.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 32/2023

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR NDËRTIMIN E URËS NDËRKUFITARE MBI LUMIN BUNA/BOJANA

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna/Bojana, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.5.2023.

Shpallur me dekretin nr. 80, datë 8.6.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

MARRËVESHJE DYPALËSHE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR NDËRTIMIN E URËS NDËRKUFITARE MBI LUMIN BUNA/BOJANA

me qëllim forcimin e marrëdhënieve miqësore që ekzistojnë midis dy vendeve;

duke marrë parasysh Planin Ekonomik dhe Investues të Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor të datës 6 tetor 2020 dhe përpjekjet e palëve për të forcuar marrëdhëniet reciproke;

në përputhje dhe në zbatim të Deklaratës së Përbashkët ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (QSH) dhe Qeverisë së Malit të Zi (QM) të nënshkruar në tetor 2018;

në përpjekje për të arritur një zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm, një ekonomi më konkurruese dhe përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve shqiptarë dhe malazezë;

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qeveria e Malit të Zi, e përfaqësuar nga Ministria e Investimeve Kapitale,

kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1
Përkufizimet

1. Termat e mëposhtëm kanë kuptimin e mëposhtëm kudo që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

a) "Palët" nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë (QSH) dhe Qeverinë e Malit të Zi (QM);

b) "Projekt" nënkupton të gjitha punimet e nevojshme të projektimit dhe të zbatimit, mbikëqyrjen, dorëzimin, rishikimet e mundshme të projektit dhe zbatimit të projektit për ndërtimin e Urës Ndërkufitare mbi lumin Buna, të bashkëfinancuara nga të dyja palët, në vijim. E referuar si "Ura";

c) "Bordi" i referohet Bordit të Përbashkët Operacional, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje;

d) "Agjencia Zbatuese" i referohet agjencisë që do të zbatojë projektin dhe që do të përcaktohet nga të dyja palët në zbatim të kësaj Marrëveshjeje;

e) "Agjencia e Monitorimit të Palëve" i referohet agjencisë që do të përcaktohet nga të dyja Palët për të monitoruar zbatimin e Projektit që do të kryhet nga Agjencia Zbatuese, duke dhënë miratimet përkatëse të fazave ose proceseve;

f) "Dizajni i projektit" u referohet grupit të skicave, raporteve, specifikimeve, detajeve teknike dhe vlerësimit sipas ligjit në fuqi.

Neni 2
Qëllimet dhe objektivat

1. Kjo Marrëveshje përcakton bazën e bashkëpunimit ndërmjet Palëve, në lidhje me Projektin, si dhe kushtet dhe procedurat për ndërtimin e Urës mbi lumin Buna/Bojana që do të përcaktohen në Protokollin Shtesë të Zbatimit dhe në varësi të burimeve të financimit.

2. Objektivi i përgjithshëm i Projektit është ndërtimi i Urës që përmirëson lidhjet ndërkufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, duke krijuar kushte për shfrytëzimin maksimal të potencialeve natyrore dhe kulturore, si dhe forcimin e zhvillimit ekonomik dhe social në rajon.

3. Objektivat specifikë:

a) promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në rajon nëpërmjet ndërhyrjeve në infrastrukturë që mundësojnë lidhjen ndërkufitare midis dy shteteve;

b) rritja e konkurrencës në drejtim të ofertës së përbashkët turistike ndërkufitare, duke përmirësuar zhvillimin ekonomik dhe social në rajon;

c) zhvillimi i produkteve të ndryshme dhe të përbashkëta turistike bazuar në pasuritë natyrore, vlerat kulturore dhe historike të dy zonave;

d) krijimi i një sinergjie midis dy shteteve.

4. Palët do të lidhin një marrëveshje të veçantë mbi ngritjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar për qëllime të kontrollit kufitar.

Neni 3
Përgjegjësia e zbatimit

1. Palët bien dakord të krijojnë një Bord me dy përfaqësues për secilën palë për të siguruar koordinimin dhe bashkëpunimin, si dhe për të miratuar afatin kohor të projektit dhe etapat që do të realizohen.

2. Nëpërmjet vendimmarrjes së Bordit, Palët bien dakord të caktojnë Agjencinë Zbatuese, e cila do të zbatojë Projektin për ndërtimin e Urës, si dhe Agjencinë e Monitorimit të Kundërpalëve.

3. Palët bien dakord që vlera e projektit për ndërtimin e Urës do të rregullohet me një marrëveshje të veçantë (protokoll zbatimi) të miratuar nga palët dhe bazuar në dokumentacionin e përgatitur.

Neni 4
Rolet dhe përgjegjësitë e palëve

1. Palët bien dakord të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar që ndërtimi i Urës të përfundojë brenda kohës së përcaktuar në Protokollin Zbatues, me qëllim përgatitjen për të lidhur seksionet kufitare me automjetet rrugore dhe hapjen e pikave të kalimit kufitar, gjatë kohës së ndërtimit të Urës.

2. Palët bien dakord të angazhohen për të shpejtuar dhe lehtësuar procedurat për miratimin e lejeve përkatëse dhe përmbushjen e detyrimeve sociale dhe mjedisore, si dhe vënien në dispozicion të tokës/kantierit, sipas nevojës për ndërtimin e urës, sipas projektit të projektit, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi të të dyja palëve.

3. Palët bien dakord që Agjencia Zbatuese për ndërtimin e Urës do të përgatitë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për prokurimin dhe mbikëqyrjen e punimeve, duke i dërguar për miratim Agjencisë së Monitorimit të Kundërpalëve, përfshirë miratimet e tjera të nevojshme gjatë ciklit të kohëzgjatjes së projektit.

Neni 5
Kontributi i Palëve (financimi)

1. Hartimi i projektit është përgatitur me burimet financiare të palës shqiptare nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Përpara procedurës së prokurimit për zbatim, pala malazeze do të japë pëlqimin për dizajnin ekzistues të projektit. Dizajni i Detajuar i Projektit do të jetë në dispozicion të Agjencisë Zbatuese.

2. Palët bien dakord të bashkëfinancojnë ndërtimin e Urës në masën 50% nga secila palë, duke përfshirë kostot totale të ndërtimit, mbikëqyrjes dhe shërbimeve të tjera që lidhen me realizimin e projektit.

3. Agjencia Zbatuese do të kryejë rishikimin e dizajnit të projektit, do të ndjekë procedurat e prokurimit, do të marrë të gjitha lejet e nevojshme për hartimin dhe zbatimin e projektit, ndërtimin, mbikëqyrjen, certifikimin e punimeve, dorëzimin.

4. Agjencia e Monitorimit të Kundërpalës konfirmon çdo fazë të zbatimit të projektit, ndryshimit, modifikimit, përshtatjes, raportimit, pagesës së punimeve dhe shërbimeve.

5. Shpenzimet që lidhen me dhënien e lejeve të nevojshme, shpronësimin, tarifat e tjera administrative, kostot operative dhe shpenzimet e tjera të nevojshme do të mbulohen përkatësisht nga secila Palë nëpërmjet autoriteteve kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi në të dyja vendet.

6. Agjencia Zbatuese do të hapë një llogari të dedikuar për Projektin në monedhën euro për të kryer të gjitha pagesat, në lidhje me zbatimin e këtij Projekti. Agjencia zbatuese, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, do të njoftojë Agjencinë e Monitorimit të Kundërpalës për detajet e llogarisë bankare të dedikuar.

7. Agjencia Zbatuese është e detyruar të informojë dhe raportojë periodikisht pranë Agjencisë/Bordit të Monitorimit të Kundërpalëve për ecurinë financiare të zbatimit, së bashku me dokumentacionin justifikues përkatës.

8. Palët do të sigurojnë që të gjitha pagesat të kryhen në përputhje me marrëveshjet e lidhura për zbatimin e projektit dhe Certifikatat e miratuara të Pagesave të Ndërmjetme.

Neni 6
Monitorimi dhe Koordinimi

1. Bordi është përgjegjës për mbikëqyrjen e progresit dhe koordinimin e përgjithshëm të Projektit dhe mblidhet të paktën 4 herë në vit.

2. Bordi kryen detyrat e mëposhtme:

a) të shqyrtojë dhe diskutojë ecurinë në lidhje me proceset përgatitore dhe ecurinë e zbatimit të Projektit;

b) të identifikojë, diskutojë dhe sugjerojë zgjidhje për problemet e mundshme dhe masat e nevojshme;

c) të shqyrtojë dhe miratojë raportet 3-mujore dhe vjetore të ecurisë së projektit.

Neni 7
Raportimi dhe informacioni

1. Raportet e progresit përgatiten nga Agjencia Zbatuese çdo 3 muaj dhe bien dakord me Agjencinë e Monitorimit të Kundër-Palëve dhe miratohen nga Bordi.

2. Të dyja Palët do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo situatë që lind, e cila mund të ketë ndikim në zbatimin e projektit dhe do të marrin pëlqimin reciprok përpara se të miratohet nga Bordi.

3. Gjuha e komunikimit ndërmjet Palëve do të jetë në anglisht.

Neni 8
Prokurimi

1. Palët bien dakord që për ndërtimin e Urës do të shpallet një tender publik ndërkombëtar, i cili do të kryhet, në varësi të mënyrës së financimit, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi të palës ku ndodhet Agjencia Zbatuese.

2. Agjencia Zbatuese është përgjegjëse për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve të ndërtimit të nevojshme për zbatimin e projektit, duke zbatuar parimet e konkurrencës së ndershme (të lirë dhe të barabartë) ndërmjet ofertuesve potencialë, me qëllim arritjen e efikasitetit në përdorimin e fondeve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9
Procedurat, detyrimet doganore dhe taksat

Palët bien dakord të bëjnë përpjekje për të thjeshtuar procedurat lidhur me trajtimin tatimor dhe doganor për ndërtimin e urës.

Palët bien dakord që materialet, mjetet, makineritë dhe pajisjet që do të përdoren për ndërtimin e Urës do të përjashtohen nga taksat doganore dhe TVSH-ja ose taksat e tjera për hyrjen ose importimin e tyre në territorin doganor të Palës tjetër, me kusht që të vërtetojnë se janë instaluar gjatë kryerjes së punimeve, ose nëse vërtetohet kthimi i tyre në territorin doganor nga i cili janë importuar.

Neni 10
Përgjegjësia për dëmin

Në rast anulimi ose braktisjeje të financimit të punimeve për ndërtimin e Urës nga njëra palë para fillimit të ndërtimit ose gjatë ndërtimit të urës, pala tjetër do të ngarkojë palën përgjegjëse për dëmin e mundshëm dhe kostot e shkaktuara dhe çështje të tilla do të përcaktohen me dispozita specifike në kuadër të marrëveshjeve që lidhen me hartimin dhe zbatimin e Projektit.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Çdo mosmarrëveshje mbi interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me konsultim dhe marrëveshje ndërmjet Palëve dhe më pas do të zgjidhet nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Neni 12
Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përmbushjen e kushteve të përcaktuara në legjislacionin e brendshëm përkatës për hyrjen e saj në fuqi dhe do të mbete në fuqi deri në përfundimin e Projektit.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Çdo ndryshim do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me procedurën e përcaktuar për hyrjen në fuqi.

Nënshkruar në Podgoricë, më 27.2.2023, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të dallimeve në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KRYEMINISTËR
Edi Rama

PËR QEVERINË E MALIT TË ZI
KRYEMINISTËR
Dritan Abazović

DEKRET
Nr. 80, datë 8.6.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 32/2023, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna/Bojana"**.**

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 36/2023

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 25/2022, "PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E *STARTUP*-EVE"

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve" bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është hartimi i një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm, për:

1. krijimin e zhvillimin e *startup*-eve dhe të veprimtarisë së punonjësve lëvizës digjitalë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

2. mbështetjen e ekosistemit vendas të *startup*-eve dhe integrimit me ekosistemin ndërkombëtar për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve e proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë për zhvillimin ekonomik.".

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat bazë, procedurat dhe organet shtetërore, që rregullojnë, mbështesin, zhvillojnë dhe integrojnë ekosistemin e *startup*-eve të Republikës së Shqipërisë, si dhe format e mbështetjes së punonjësve lëvizës digjitalë.".

Neni 3

Shkronja "ç" e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

"ç) "punonjësit lëvizës digjitalë" janë shtetasit e huaj, që përdorin teknologjinë e komunikimit për të ofruar shërbimet e tyre profesionale dhe/ose kryejnë këto shërbime për llogari të entiteteve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pa pasur një zyrë apo seli të regjistruar, të cilët marrin statusin dhe përfitimet e "punonjësit lëvizës digjital" në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për të huajt;".

Neni 4

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 5/1
Format e mbështetjes së punonjësve lëvizës digjitalë

1. Përjashtimisht nga përkufizimi i rezidencës tatimore, siç përcaktohet në legjislacionin tatimor, punonjësit lëvizës digjitalë nuk do të konsiderohen rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë prej 12 muajsh.

2. Pavarësisht ndonjë dispozite të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, një entitet jorezident nuk do të konsiderohet që krijon seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë vetëm se merr shërbime nga një punonjës lëvizës digjital ose vetëm sepse ka punësuar një punonjës lëvizës digjital.

3. Veprimtaria e punonjësit lëvizës digjital nuk konsiderohet se krijon një vend fiks biznesi dhe nuk konsiderohet se vepron si një agjent i pavarur i një entiteti jorezident në Republikën e Shqipërisë për sa kohë punonjësi lëvizës digjital nuk ka autoritetin të përfundojë kontrata në emër të entitetit jorezident apo nuk angazhohet në ndonjë veprimtari që nuk është e lidhur me rolin e tij si punonjës lëvizës digjital.

4. Punonjësit lëvizës digjitalë pajisen me leje unike bazuar në ligjin "Për të huajt" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.".

Neni 5

Pas shkronjës "c" të nenit 6 shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç) agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve".

Neni 6

Në nenin 7 në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

a) shkronja "d" ndryshohet si më poshtë:

"d) miraton modelet tip të marrëveshjes së bashkëpunimit që nënshkruhen ndërmjet agjencisë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe *startup*-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta;".

b) shkronja "ë" ndryshohet si më poshtë:

"ë) mbikëqyr administrimin e regjistrit të *startup*-eve dhe të lehtësuesve në përputhje me parashikimet e këtij ligji;".

c) shkronja "f" ndryshohet si më poshtë:

"f) administron faqen zyrtare në internet të institucionit, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, si edhe publikon thirrjet për grante;".

ç) shkronjat "gj" dhe "h" shfuqizohen.

Neni 7

Pika 3 e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

"3. Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve vepron si sekretariat teknik i Këshillit dhe e mbështet atë për përmbushjen e detyrave të parashikuara nga ky ligj.".

Neni 8

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 9/1
Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve

1. Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve është njësia menaxhuese

dhe monitoruese e realizimit të masave mbështetëse financiare nëpërmjet fondeve publike ose me të tretë për nismat në ekosistemin e *startup*-eve.

2. Rregullat për funksionimin dhe organizimin e agjencisë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe lehtësuesve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 9

Pika 2 e nenit 10 ndryshohet si më poshtë:

"2. Kohëzgjatja e periudhës së inkubimit dhe e statusit si *startup* është 24 (njëzet e katër) muaj nga momenti i vetëdeklarimit në regjistrin e *startup*-eve, me të drejtë rinovimi.".

Neni 10

Pika 1 e nenit 11 ndryshohet si më poshtë:

"1. Regjistri i *startup*-eve dhe lehtësuesve (në vijim "Regjistri") administrohet nga agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve, si bazë shtetërore të dhënash, në funksion të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.".

Neni 11

Pika 1 e nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

"1. Me qëllim mbështetjen e zhvillimit dhe rritjes së *startup*-eve, ofrohet shërbimi *startup one-stop-shop* pranë agjencisë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve.".

Neni 12

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve i propozon ministrit përgjegjës për sipërmarrjen shpalljen e thirrjes për aplikime nga ana e *startup*-eve dhe lehtësuesve të *startup*-eve dhe kryen publikimin në shërbimin *startup one-stop-shop* në faqen zyrtare.".

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Me qëllim vlerësimin e kërkesave nga *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve ngrihet komisioni i vlerësimit dhe komisioni i ankimit. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen cakton kryetarët e këtyre komisioneve. Rregullat e hollësishme për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe komisionit të ankimit, kriteret, procedura e përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

3. Pikat 6 dhe 7 ndryshohen si më poshtë:

"6. Vendimi i komisionit të vlerësimit për përfituesit e granteve financiare për mbështetjen e *startup*-eve, sipas thirrjes dhe në përfundim të procesit të ankimit, miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen. Urdhri botohet në faqen zyrtare të agjencisë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve në faqen zyrtare të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

7. Urdhri i ministrit përgjegjës për sipërmarrjen zbatohet nga agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve.

Neni 13

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve gjatë periudhës së inkubimit dhe deri në përfundimin e zbatimit të projektit të mbështetur financiarisht si *startup* ose si lehtësues i *startup*-eve, monitoron periodikisht *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, që kanë fituar masë mbështetëse nëpërmjet granteve, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë gjatë zbatimit të këtij ligji.".

2. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.5.2023.

Shpallur me dekretin nr. 81, datë 8.6.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 81, datë 8.6.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 36/2023, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 25/2022, 'Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve"'.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 37/2023

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 1, DATË 27.4.2023, "PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002, 'PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 27.4.2023, "Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, 'Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë', të ndryshuar".

Miratuar në datën 25.5.2023.

Shpallur me dekretin nr. 82, datë 9.6.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 82, datë 9.6.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 37/2023, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 1, datë 27.4.2023, 'Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, 'Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë"", të ndryshuar.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 320, datë 31.5.2023

PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË TRAJTIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE NË PËRDORIM, NË KUSHTET E NENIT 12, TË LIGJIT NR. 20/2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Task-Forcës ndërinstitucionale për mënyrën e trajtimit të pasurive të paluajtshme "tokë bujqësore", në përdorim të personave fizikë (individë) pa titull pronësie, të cilët gjenden në kushtet e nenit 12, të ligjit nr. 20/2020.

2. Qëllimet e këtij vendimi dhe të veprimtarisë së Task-Forcës që krijohet nëpërmjet tij janë:

a) identifikimi i problematikave në lidhje me zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi për tokat bujqësore në përdorim, pa titull pronësie;

b) hartimi i planit të veprimit për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikës;

c) koordinimi ndërmjet institucioneve qendrore, vendore, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe përdoruesve faktikë të tokës bujqësore, në funksion të zgjidhjes përfundimtare të problematikave.

3. Task-Forca krijohet për njësi administrative territoriale të veçanta dhe përbërja e saj miratohet me urdhër të Kryeministrit. Task-Forca drejtohet nga kryetari dhe ka në përbërje të saj deri në një përfaqësues të secilit prej institucioneve të mëposhtme:

a) Agjencia Shtetërore e Kadastrës;

b) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

ç) Ministria e Drejtësisë;

d) Agjencia e Trajtimit të Pronës;

dh) Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

4. Krahas anëtarëve të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, në veprimtarinë e Task-Forcës mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në njësinë administrative vendore pranë së cilës Task-Forca do të ushtrojë detyrat e saj.

5. Kryetari i Task-Forcës përgjigjet para Kryeministrit për veprimtarinë e Task-Forcës dhe raporton në mënyrë periodike çdo muaj pranë tij. Në rast se Kryetari nuk është njëkohësisht edhe punonjës në ndonjë nga institucionet e administratës shtetërore, ai trajtohet me pagë me nivelin e drejtorit të përgjithshëm të përmbajtjes në ministri.

6. Në mbështetje të veprimtarisë së Task-Forcës, pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës formohet sekretariati teknik i saj, i përbërë nga punonjës të kësaj Agjencie. Punonjësit e sekretariatit caktohen nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së.

7. Objekt i veprimtarisë së Task-Forcës janë pasuritë e paluajtshme që plotësojnë këto kushte:

a) janë braktisur nga subjekti pretendues ligjor dhe nuk janë regjistruar pranë ASHK-së;

b) janë toka bujqësore (sipas zërave përkatës të saj);

c) nuk janë prona private të të tretëve;

ç) nuk janë objekt i formave të kompensimit fizik, sipas legjislacionit në fuqi për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave;

d) nuk janë zënë nga ndërtime pa leje të të tretëve apo të vetë subjektit kërkues;

dh) nuk janë objekt i investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë;

e) nuk janë prona shtetërore të destinuara për qëllime turistike;

ë) nuk janë prona publike të patjetërsueshme;

f) nuk janë të zëna nga ndërtimet, objekt trajtimi, të nenit 34, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

8. Detyrat e Task-Forcës janë:

a) të evidentojë sipërfaqet që gjenden në kushtet e përcaktuara në pikën 7, të këtij vendimi;

b) të identifikojë poseduesit faktikë që zotërojnë sipërfaqet në fjalë dhe të hartojë një listë të posaçme për nevoja pune, në dispozicion të ASHK-së;

c) të analizojë nëse rrethanat e këtyre rasteve, në tërësi, përmbajnë ose jo premisat për fitimin e pronësisë, sipas mënyrave origjinale të parashikuara në Kodin Civil apo mënyrave të tjera të posaçme, të parashikuara në ligje të veçanta;

ç) të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim finalizimin e proceseve, për kërkesat e dorëzuara pranë këtij institucioni (ASHK) prej organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore;

d) të hartojë raporte periodike për problematikat e ndeshura, trajtimin e çështjes dhe identifikimin e zgjidhjes, në funksion të qëllimit të këtij vendimi;

dh) të bashkërendojë punën me institucionet e përfshira, në funksion të realizimit të detyrave;

e) të hartojë planin e veprimit për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikës në lidhje me tokat bujqësore në përdorim të personave fizikë (individë) pa titull pronësie.

9. Për zbatimin e detyrave të përcaktuara në pikën 8, të këtij vendimi, Task-Forca mbështetet në strukturat administrative dhe burimet e institucioneve të përfshira në formimin e saj, sipas kompetencave dhe ekspertizës përkatëse.

10. Drejtuesit e institucioneve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, i përcjellin sekretariatit të Task-Forcës emrat e përfaqësuesve të tyre brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

11. Task-Forca është e detyruar të përmbushë detyrat e përcaktuara në pikën 8, të këtij vendimi, brenda 1 (një) viti nga hyrja e tij në fuqi.

12. Task-Forca, në funksion të zbatimit të detyrave të saj, mund të kërkojë informacion pranë

institucioneve të përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, dhe çdo institucioni tjetër që zotëron të dhëna dhe dokumentacion që i shërben qëllimit të veprimtarisë së saj. Këto institucione janë të detyruara t'i përgjigjen asaj në përputhje me afatet e përcaktuara në aktin nënligjor në fuqi mbi procedurat e bashkëpunimit të organeve të administratës shtetërore.

13. Shpenzimet për pagën e kryetarit të Task-Forcës, nëse është punonjës i institucioneve të administratës shtetërore, paguhen nga institucioni ku është i punësuar. Nëse nuk është i tillë, ato përballohen nga Kryeministria.

14. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 344, datë 6.6.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998, "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", të ndryshuar; pika 20, e kreut IV "Procedurat që ndiqen për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", të vendimit nr. 373, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së nënshkrimit të kontratave të qirasë së tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Mirgen Dobruna, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm (i komanduar).

2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm (i komanduar).

4. Urdhri nr. 311, datë 29.6.2022, i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për delegim kompetencash", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 347, datë 7.6.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 438, DATË 7.10.2008, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'MBI KUSHTET E SHËNDETIT PUBLIK DHE SHËNDETIT TË KAFSHËVE, TË CERTIFIKATAVE TË QUMËSHTIT LËNDË E PARË DHE TË PRODUKTEVE ME BAZË QUMËSHTI PËR KONSUM HUMAN'", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 438, datë 7.10.2008, "Për miratimin e rregullores 'Mbi kushtet e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve, të certifikatave të qumështit lëndë e parë dhe të produkteve me bazë qumështi për konsum human'", të ndryshuar, bëhet ndryshimi më këtë përmbajtje:

a) Në listën e vendeve të treta ose pjesë të autorizuara të tyre, sipas tabelës në shtojcën që i bashkëlidhet këtij urdhri, dhe është pjesë përbërëse e tij, shtohet me të dhënat si më poshtë:

Kodi ISO i vendit të tretë	Vendi i tretë ose pjesë të tij	Kolona A	Kolona B	Kolona C
MD	Moldavi	0	0	+

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË
ÇËSHTJA HYSA KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 52048/16)

VENDIM

Neni 5 § 3 – Arsyeshmëria e paraburgimit – Mosdhënia e arsyeve të duhura dhe të mjaftueshme nga gjykatat vendëse për të justifikuar paraburgimin e kërkueses – Të meta në arsyetim të pakorrigjuara me anë të shqyrtimit në kasacion ose shqyrtimit kushtetues, për shkak të refuzimit të Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar dënimin me burg

STRASBURG
21 shkurt 2023

I FORMËS SË PRERË
21.5.2023

Ky vendim është bërë i formës së prerë sipas nenit 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen Hysa kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *kryetar,*
Georgios A. Serghides,
Yonk Grozev,
Jolien Schukking,
Darian Pavli,
Peeter Roosma,
Ioannis Ktistakis, *gjyqtarë*
dhe Milan Blaško, *Sekretar i Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 52048/16) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga një shtetase shqiptare, znj. Afërdita Hysa ("ankuesja"), më 22 gusht 2016;

vendimin për të njoftuar Qeverinë shqiptare ("Qeveria") për ankesat sipas nenit 5 §§ 3 dhe 4 të Konventës, në lidhje me mungesën e pretenduar të arsyeve të duhura dhe të mjaftueshme që justifikojnë paraburgimin e kërkueses, si edhe shqyrtimin nga gjykata vendëse – të pretenduar si jo efektiv – të apelimeve të saj për këtë çështje; dhe

vendimin për ta shpallur pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

vërejtjet e palëve;

për kërkesën;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 13 dhjetor 2022 dhe 31 janar 2023;

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e fundit.

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për mungesën e arsyeve të duhura dhe të mjaftueshme për të justifikuar paraburgimin e kërkuesit.

FAKTET

2. Kërkuesja ka lindur në vitin 1968 dhe jeton në Tiranë. Fillimisht, ajo u përfaqësua nga P. Thaçi dhe në vijim nga Z. F. Caka, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

3. Qeveria shqiptare ("Qeveria") fillimisht u përfaqësua nga ish-agjenti i saj z. B. Lilo, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

I. PRIVIMI I KËRKUESES NGA LIRIA

4. Në periudhën përkatëse, kërkuesja ishte e punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve dhe mbante pozicionin e drejtoreshës së Drejtorisë së Kontrollit.

A. Periudha e parë e burgimit

1. Vendim i Gjykatës së Rrethit Tiranë

5. Mbështetur në një kërkesë të paraqitur nga Prokuroria e Tiranës dhe pas një seance gjyqësore mbajtur në mungesë të kërkueses, në datën 5

nëntor 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë lëshoi urdhrin për paraburgimin e kërkueses me dyshimin se ajo kishte kryer veprën e shpërdorimit të detyrës, në kundërshtim me nenin 248 të Kodit Penal.

6. Gjykata arriti në përfundimin se ishin përmbushur kushtet për dhënien e masës së burgimit parashikuar nga nenet 228 dhe 229 i Kodit të Procedurës Penale (shih paragrafët 29–30 më poshtë). Gjykata konstatoi se kërkuesja ishte pezulluar pasi (gjatë periudhës kur vepronte në pozicionin e saj zyrtar) kishte miratuar rimbursim për një sërë kompanish në vlerën prej 515,455,275 lekësh (LEK – rreth 3.7 milionë euro (EUR) në periudhën konkrete) për taksën e vlerës së shtuar, në shkelje të legjislacionit të zbatueshëm për tatimet.

7. Përveç përshkrimit në detaje të shkeljes së dyshuar të rregullave përkatës për tatimet, gjykata iu referua "rrethanave të kryerjes së shkeljes dhe rrezikun për arratisje të së dyshuarës".

8. Gjithashtu, gjykata theksoi se:

"Në dhënien e masës së sigurisë së "paraburgimit", [g]jykata mban në konsideratë veçanërisht pajtueshmërinë e kësaj mase sigurie me kërkesat e çështjes në fjalë. Gjykata e konsideron këtë masë sigurie proporcionale me aspektin se sa të rënda janë faktet dhe dënimin për këtë vepër penale. Vepra e "shpërdorimit të detyrës", për të cilën Afërdita Hysa është e dyshuar, ka pasur pasojë të rënda për financat e shtetit në shumën prej 515,455,275 lekësh [shqiptarë], [dhe] vlerësohet nga [g]jykata sipas rrezikut që ajo përbën për shoqërinë, qëllimin e saj, pasojat e shkaktuara prej saj, formën [që ka marrë], llojin dhe kohëzgjatjen e dënimit që parashikohet nga ligji [për këtë vepër], si edhe rrethanat rënduese dhe lehtësuese që ekzistojnë në këtë fazë të hetimit.

Duke pasur parasysh këto kushte, [g]jykata vendos të urdhërojë ndalimin e të dyshuarës Afërdita Hysa, pasi vlerëson se çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme.".

9. Më 6 nëntor 2013, kërkuesja u vetëdorëzua tek autoritetet, dhe më 9 nëntor 2013, pas një seance tjetër gjyqësore gjatë së cilës ajo ishte e pranishme, Gjykata e Rrethit Tiranë konfirmoi se përmbusheshin kushtet për paraburgimin e kërkueses. Dosja e çështjes nuk përmban procesverbalin e kësaj seance.

10. Përveç kërkueses, dyshohej se në zhvillimet e përmendura më sipër ishin përfshirë edhe një sërë individësh të tjerë që kishin vepruar privatisht – si edhe katër zyrtarë të tjerë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, në cilësinë e pozicionit të tyre zyrtar.

2. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë

11. Më 15 nëntor 2013, kërkuesja e apeloi vendimin e mësipërm pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Ajo pretendonte se paraburgimi i saj nuk ishte i justifikuar dhe argumentonte se fakti se ajo ishte vetëdorëzuar vullnetarisht në polici tregonte se nuk ekzistonte rreziku se ajo mund të arratisej; për më tepër, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, ajo kishte punuar për autoritetet tatimore, ishte e martuar me një oficer policie dhe ishte nëna e dy fëmijëve të vegjël.

12. Ajo shtonte se ajo nuk ishte në pozitën që të prekte provat pasi ishte pezulluar nga detyra, dhe se, në çdo eventualitet, dosjet konkrete të autoriteteve tatimore ishin sekuestruar nga Prokuroria e Rrethit Tiranë.

13. Në fund, ajo argumentonte se masa e paraburgimit nuk ishte proporcionale me akuzat me të cilat po përballej ajo, dhe se gjendja e saj e keqe shëndetësore tregonte se një masë sigurie më pak e ashpër do të ishte më e përshtatshme.

14. Më 27 nëntor 2013, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës më të ulët. Gjykata u mbështet kryesisht në të njëjtin arsyetim bërë nga Gjykata e Rrethit Tiranë në lidhje me dyshimin se kërkuesja kishte kryer një vepër penale; megjithatë, ajo nuk iu referua faktit se kërkuesja paraqiste rrezikun për t'u arratisur. Megjithatë, ajo gjykonte si më poshtë:

"Në çështjen konkrete, Gjykata e Apelit…, me qëllim zgjedhjen e masës së duhur të sigurisë e cila do të garantonte … sigurinë për sa i përket faktit se e dyshuara mund të kryejë të njëjtën vepër penale apo një vepër tjetër më të rëndë, mban në konsideratë sa më poshtë:

- aktet atribuar të dyshuarës konsiderohen të jenë të rënda, referuar dënimit parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal;

- vepra penale në fjalë përbën një rrezik të caktuar ndaj shoqërisë;

- e dyshuara përbën rrezik për shoqërinë, duke pasur në konsideratë rrethanat e kryerjes së veprës për të cilën ajo dyshohet, [dhe] faktin se veprimet janë kryer në emër të institucionit përgjegjës për kontrollet [tatimore] dhe kanë shkaktuar një dëm të

konsiderueshëm ekonomik ndaj interesave të shtetit…

Referuar rrethanave, në kundërshtim me atë çfarë pretendohet në ankesën e personit nën hetim, nevojat e sigurisë për çështjen konkrete mund të garantohen vetëm me anë të masës së sigurisë "me burgim", dhe se çdo masë tjetër është gjykuar me të drejtë si e papërshtatshme.".

3. Gjykata e Lartë

15. Më 3 dhjetor 2013, kërkuesja paraqiti një rekurs në kasacion (në Gjykatën e Lartë), kryesisht duke iu referuar argumenteve të saj të mëparshëm (shih paragrafët 11–13 më sipër).

16. Më 19 dhjetor 2013, Gjykata e Lartë e pushoi rekursin e kasacionit të kërkueses me katër vota pro dhe një kundër me anë të një vendimi *de plano*, sipas së cilit gjykohej se pretendimet e kërkueses nuk i përkisnin juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

4. Gjykata Kushtetuese

17. Më 14 shtator 2015, kërkuesja paraqiti një apelim kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese, me anë të së cilit, për sa ka të bëjë me çështjen konkrete, ajo u mbështet në mënyrë të drejtpërdrejtë në nenin 5 të Konventës, dhe përsërit argumentet e saj të mëparshëm (shih paragrafët 11–13 më sipër).

18. Më 24 shkurt 2016, Gjykata Kushtetuese, me pesë vota pro dhe tre kundër, e rrëzoi ankesën e kërkueses si të papranueshme me arsyetimin se i mungonin argumentet, pasi masa me burgim ndaj saj tashmë ishte zëvendësuar me masën arrest shtëpie në datën 19 qershor 2014 (shih paragrafin 22 më poshtë). Gjykata thekson se kërkuesja nuk kishte interes që të kundërshtonte një masë sigurie të zëvendësuar me një masë tjetër.

19. Një gjyqtar bashkëlidhi një opinion kundërshtues, me anë të së cilit pohonte, midis argumentesh të tjerë, se individët duhet të lejohen të kundërshtojnë kushtetueshmërinë e privimit të tyre të lirisë, edhe nëse, në kohën kur shqyrtohet ky qëndrim kundërshtues, masa e arrestit me burg ndaj tyre mund të jetë zëvendësuar nga një masë më e butë. Ai argumentonte se një individ i mbajtur në burgim në një shkelje të mundshme të Kushtetutës do të vuante paragjykim të konsiderueshëm, që nuk do të reduktohej apo kompensohej me anë të një revokimi të mëpasshëm të asaj mase ndalimi. Së fundmi, duke cituar precedentë të ndryshëm (shih paragrafët 39–41 më poshtë), gjyqtari me anë të opinionit të tij kundërshtues shtonte se Gjykata Kushtetuese, me anë të vendimit për të rrëzuar ankimin, ndahej pa ndonjë arsye të mirë nga praktika gjyqësore e konsoliduar e asaj gjykate. Për këto arsye, ai arrinte në përfundimin se gjykata duhej ta kishte shqyrtuar me Kushtetutën pajtueshmërinë e privimit të kërkueses nga liria, më së shumti për shkak të problematikave *prima facie* që shpalosi çështja.

B. Periudhat e mëpasshme

20. Sakaq, në datën 6 shkurt 2014, kërkuesja paraqiti një kërkesë *habeas corpus,* me anë të së cilës kërkonte që Gjykata e Rrethit Tiranë ta zëvendësonte arrestin e saj me burg me një masë sigurie më të lehtë. Më 11 prill 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi kërkesën.

21. Më 24 prill 2014, kërkuesja paraqiti një tjetër kërkesë *habeas corpus*. Më 13 maj 2014, trupa gjykuese e Gjykatës së Rrethit Tiranë konstatoi se faza hetimore e procesit gjyqësor kishte përfunduar më 8 maj 2014, kur prokurori kishte kërkuar gjykimin e kërkueses. Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa *habeas corpus* e kërkueses, do të duhej të shqyrtohej nga trupa gjykuese e Gjykatës së Rrethit përpara së cilës ishte pezull shqyrtimi i çështjes penale për meritat; në vijim ajo e përcolli kërkesën në përputhje me rrethanat.

22. Më 19 qershor 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë e pranoi kërkesën dhe urdhëroi që kërkuesja të kalonte në arrest shtëpie nën mbikëqyrje elektronike.

II. VENDIME MBI MERITAT E AKUZËS PENALE

23. Më 8 tetor 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë e shpalli kërkuesen fajtore për shpërdorim të detyrës kryer në bashkëpunim me persona të tjerë, në kundërshtim me nenet 25 dhe 135 të Kodit Penal. Ajo e dënoi kërkuesen me pesë vite burgim.

24. Më 8 prill 2015, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët; megjithatë ajo urdhëroi që ekzekutimi i vendimit të pezullohej me kushtin që kërkuesja të mos kryente ndonjë vepër tjetër për pesë vjet. Për këtë arsye, kërkuesja u la e lirë.

25. Pas vendimit të Gjykatës së Lartë për të hequr pezullimin e dënimit për kërkuesen, dhe një vendimi të mëpasshëm dhënë nga Gjykata Kushtetuese që e dërgonte çështjen për rigjykim, më 19 shkurt 2018, Gjykata e Lartë la në fuqi

vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë të datës 8 prill 2015.

KUADRI LIGJOR DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

I. LIGJI VENDËS

A. Kushtetuta

26. Pjesët përkatëse të neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës parashikojnë, si më poshtë:

"Neni 27

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:

…

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

…

Neni 28

1. Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij.

2. Personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi "c", duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.

3. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.

4. Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.

5. Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij."

27. Pjesa përkatëse e nenit 134 § 2 të Kushtetutës parashikon se individët mund të paraqesin një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese vetëm për çështjet që kanë lidhje me interesat e tyre.

B. Ligji për Gjykatën Kushtetuese (ligji nr. 8577, i datës 10 shkurt 2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë")

28. Neni 30 i ligjit për Gjykatën Kushtetuese, në fuqi në periudhën konkrete, parashikonte se afati për dorëzimin e ankesave individuale në Gjykatën Kushtetuese ishte dy vjet.

C. Kodi i Procedurës Penale ("KPP")

29. Sipas nenit 228 § 1 të KPP-së, në fuqi në periudhën konkrete, një masë sigurimi personal do të vendosej nëse, sipas të dhënave, ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se një i pandehur kishte kryer një krim. Sipas nenit 228 § 2, nuk mund të vendoset asnjë masë sigurimi personal kur ka shkaqe sipas së cilave individi mund të mos dënohet, ose nëse vepra bëhet e pandjekshme penalisht. Sipas nenit 228 § 3, masat e sigurimit vendosen, kur: a) ekzistojnë arsye të rëndësishme të cilat do të vinin në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; b) i pandehuri i është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) ekziston rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit, mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

30. Sipas nenit 229 § 1 të KPP-së, për dhënien e masës së sigurimit personal, një gjykatë mban në konsideratë përshtatshmërinë e saj dhe masën e nevojshme të sigurisë, për çështjen konkrete. Sipas nenit 229 § 2 të KPP-së, gjykata duhet të mbajë në konsideratë edhe rëndësinë e akteve që i atribuohen të dyshuarit, masën e dënimit të parashikuar, çdo tendencë të personit të dyshuar për të kryer përsëri një vepër penale (nëse ai ose ajo është dënuar për krime të mëparshme), dhe çdo rrethanë lehtësuese dhe rënduese.

31. Neni 230 § 1 i KPP-së parashikon se arresti me burg mund të vendoset nëse asnjë masë tjetër nuk është e përshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës konkrete dhe të pandehurit. Neni 230 § 2 parashikon se arresti me burg nuk mund të vendoset ndaj një gruaje që është shtatzënë ose një gruaje që ushqen me gji, ndaj një personi që vuan nga një situatë veçanërisht

e rëndë shëndetësore, si edhe në një sërë rastesh të tjera.

32. Sipas nenit 232 të KPP-së, një gjykatë mund të urdhërojë masat e mëposhtme kufizuese: ndalimi i daljes jashtë shtetit; detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore; ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar; garancia pasurore; d) arresti në shtëpi; arresti në burg; shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik.

33. Sipas nenit 240 të KPP-së, një gjykatë mund të urdhërojë masat e mëposhtme ndaluese të sigurimit personal: pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik; ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.

34. Neni 268 § 2 i KPP-së parashikon se individët të cilët që kanë qenë të paraburgosur, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229, kanë të drejtën të kompensohen për paraburgimin e vuajtur.

D. Kodi Penal

35. Neni 135 i Kodit Penal parashikon veprën e "vjedhjes së kryer duke shpërdoruar detyrën".

36. Neni 248 i Kodit Penal parashikon veprën e "shpërdorimit të detyrës".

E. Kompensim për dënimin penal të padrejtë (ligji nr. 9381 i datës 28 prill 2005)

37. Nenet 2 dhe 3(ç) të ligjit parashikojnë të drejtën e një individi për kompensim për vuajtjen e paraburgimit të paligjshëm në të njëjtat kushte si ato të parashikuara në nenin 268 § 2 të KPP-së (shih paragrafin 34 më sipër). Sipas nenit 8(3) të ligjit, pretendimi për kompensim duhet të dorëzohet pranë gjykatës përkatëse të shkallës së parë.

II. PRAKTIKA GJYQËSORE VENDËSE

A. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë në lidhje me masat e arrestit

38. Në vendimin nr. 7 të datës 14 tetor 2011, Gjykata e Lartë, e mbledhur në një formacion plenar (Kolegjet e Bashkuara) pranoi, për sa ka të bëjë me çështjen, se:

"9. ... ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm mbështetur në prova ndaj të pandehurit *(fumus delicti)* është vetëm kushti fillestar, [ose] parakushti, për zbatimin e masës së sigurimit personal. Ky kusht [ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm] nuk përjashton – përkundrazi, ai nënkupton – se përveç kësaj [këtij dyshimi], është e nevojshme të provohet të paktën njëri prej kushteve dhe kritereve të tjera ligjore, të cilat bëjnë fjalë për një masë sigurimi personal, si edhe për përshtatshmërinë e masës aktuale të sigurimit [që do të vendoset për të] kufizuar lirinë e të pandehurit (*periculum libertatis*). Procesi gjyqësor që vendos ose shqyrton nevojën për një masë sigurimi, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji, mbështetet dhe ka për qëllim të arrijë balancën e nevojshme midis, nga njëra anë, respektit për (dhe mbrojtjen e) rendit publik dhe ... administrimin e drejtësisë, dhe, nga ana tjetër, të drejtat dhe interesat ligjorë të individit që i nënshtrohet procesit gjyqësor – ku që të dyja parashikohen në Kushtetutë.

...

Sipas interpretimit korrekt të kuptimit që i duhet dhënë termit "rrezik", sipas nenit 228 [të KPP] në tërësi – duke përfshirë paragrafin (a) të atij neni – gjykata arrin në përfundimin e unifikuar se në çdo fazë të procesit gjyqësor, kërkesa e paraqitur nga prokuroria dhe vendimi i gjykatës me anë të së cilit vendoset masa e sigurimit personal duhet të arsyetohen [në mënyrën e duhur], ..., dhe [duhet] të përcaktojnë (konkretisht) nevojën për një masë sigurimi personal dhe [të detajojnë] arsyet e rëndësishme në lidhje me "rrezikun" [konkret] – që do të thotë, probabilitetin [ose] mundësinë reale që procesi gjyqësor (*plerumque accidit*) do të rrezikohet nga i pandehuri.".

B. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese për paraburgimin

39. Në vendimin nr. 28, të datës 23 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi një grup ankesash ndaj vendimit gjyqësor me anë të së cilit urdhërohej arrestimi i ankueses. Gjykata Kushtetuese theksonte se vendosja e një mase sigurimi kishte të bënte në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut për personin e prekur – që do të thotë me lirinë personale të një individi. Gjithashtu, gjykata citonte praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut sipas nenit 5 të Konventës. Pas zbatimit të parimeve të zbatueshme për çështjen konkrete Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankimet.

40. Në vendimin nr. 40, të datës 18 korrik 2012, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi një ankesë ku thuhej se Gjykata e Apelit Tiranë kishte gabuar në përllogaritjen e afatit për të apeluar kundër një vendimi të gjykatës së shkallës së parë, me anë të së

cilit urdhërohej arrestimi i ankuesit. Gjykata Kushtetuese konstatoi se ankimi ishte i pranueshëm, pavarësisht faktit, se: i. në grupin vijues të procedurave, gjykatat e zakonshme kishin zëvendësuar paraburgimin e kërkuesit me arrest në arrest shtëpie; dhe ii. më pas ai ishte arrestuar mbështetur në fuqinë e një vendimi që vendoste dënimin me burgim.

41. Për sa ka të bëjë me meritat e çështjes përpara saj, gjykata shqyrtoi aspektin nëse procesi që çoi në paraburgimin e kërkuesit kishte zbatuar kërkesat për "një seancë të drejtë", sipas Kushtetutës. Pas atij shqyrtimi, gjykata e mbështeti ankesën, duke gjykuar se ishte shkelur e drejta e kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës së apelit për të kundërshtuar paraburgimin dhënë nga gjykata e shkallës së parë, për shkak të keqzbatimit të ligjit përkatës. Megjithatë, duke pasur parasysh se procesi i paraburgimit ishte bërë i dyshimtë, Gjykata Kushtetuese nuk urdhëroi rigjykim përpara gjykatave të zakonshme.

LIGJI

42. Në mbështetje të nenit 5 § 1 (c) të Kushtetutës, kërkuesja u ankua se vendimet vendëse që urdhëronin burgimin e saj nuk përmbanin arsyetimin e duhur dhe të mjaftueshëm, dhe as nuk u referoheshin rrethanave të saj personale. Sipas nenit 5 § 4 të Konventës, ajo u ankua edhe se apelimet e saj, në lidhje me arrestimin e saj nuk ishin shqyrtuar në mënyrën e duhur. Gjykata, duke qenë kompetente në karakterizimin e fakteve të çështjes sipas ligjit, gjykon se këto ankesa duhet të shqyrtohen sipas nenit 5 § 3 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.".

I. ZBATIM I NENIT 37 § 1 (b) TË KONVENTËS

43. Qeveria parashtroi se më 19 qershor 2014, gjykatat vendëse kishin zëvendësuar paraburgimin e kërkueses me arrest shtëpie (shih paragrafin 22 më sipër), dhe se më 8 prill 205, ajo ishte lënë e lirë (shih paragrafin 24 më sipër). Në këtë mënyrë, sipas këndvështrimit të Qeverisë çështja ishte zgjidhur dhe duhet të çregjistrohet nga lista e çështjeve të Gjykatës në mbështetje të nenit 37 § 1 (b) të Konventës.

44. Kërkuesja mbështeti ankesat e saj pa e adresuar këtë çështje.

45. Gjykata vëren se pjesa e ankesave të kërkueses që tashmë janë përpara saj lidhen me periudhën e parë të burgimit të saj, që zgjati pesë muaj dhe pesë ditë. Ajo periudhë filloi më 6 nëntor 2013, kur ajo u dënua me burgim sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, të datës 5 nëntor 2013 (shih paragrafin 9 më sipër). Periudha e burgimit përfundoi më 11 prill 2014, kur gjykatat vendëse e rrëzuan kërkesën e saj *habeas corpus* (shih paragrafin 20 më sipër), duke shkaktuar në këtë mënyrë periudhën e dytë të burgimit të kërkueses, për të cilën ankimet e saj tashmë janë deklaruar të papranueshme.

46. Në vijim, Gjykata vëren se as vendimi vendës i datës 19 qershor 2014 që e vendoste kërkuesen në arrest shtëpie (shih paragrafin 22 më sipër) dhe as vendimi i datës 8 prill 2015 që pezullonte dënimin e saj me burgim (shih paragrafin 24 më sipër), nuk përfshinte ndonjë përcaktim për pajtueshmërinë e paraburgimit fillestar të kërkueses me nenin 5 § 3 të Konventës – një problematikë që shtrihet në zemër të çështjes së saj përpara Gjykatës. Përkundrazi, të gjithë apelimet vendëse, në lidhje me periudhën e parë të burgimit të kërkueses u rrëzuan nga gjykatat vendëse.

47. Ndërprerja e mëpasshme e paraburgimit të kërkueses nuk e ndryshonte faktin se ajo, sidoqoftë, kishte qenë në burgim për pesë muaj e pesë ditë. Për këtë arsye, ajo ka të drejtën të ankohet në Gjykatë se burgimi i saj ishte në kundërshtim me nenin 5 § 3 të Konventës. Më tej, ajo vijon se ndryshe nga parashtrimi i Qeverisë, çështja nuk është zgjidhur dhe nuk janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 37 § 1 (b) të Konventës.

48. Në këtë mënyrë, Gjykata rrëzon kërkesën e Qeverisë që kërkesa të çregjistrohet nga lista e saj e çështjeve.

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 5 § 3 TË KONVENTËS

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

49. Qeveria iu referua nenit 34 të Konventës, duke kundërshtuar se në datën kur ishte paraqitur

kërkesa, kërkuesja nuk ishte e privuar nga liria; për këtë arsye ajo nuk kishte pasur statusin e viktimës, dhe kështu, nuk kishte të drejtë të paraqiste një ankesë pranë Gjykatës.

50. Gjithashtu, Qeveria kundërshtoi se ankesat nuk ishin të mbështetura në fakte.

51. Kërkuesja përsëriti ankesat e saj, pa iu përgjigjur argumenteve të mësipërme.

2. Vlerësimi i Gjykatës

52. Gjykata përsërit se fjala "viktimë", sipas kontekstit të nenit 34 të Konventës, përcakton personin që preket drejtpërdrejtë nga veprimi ose mosveprimi konkret. Rrjedhimisht, një vendim apo masë në favor të kërkuesit në parim nuk është mjaftueshëm për ta privuar atë nga statusi i tij si "viktimë", nëse autoritetet vendëse nuk kanë pranuar, shprehimisht ose në thelb, duke korrigjuar më pas, shkeljen konkrete të Konventës (shih, midis autoritetesh të tjera, *Sakhnovskiy kundër Rusisë* [DHM], nr. 21272/03, § 67, 2 nëntor 2010). Natyra ndihmëse e mekanizmit mbrojtës së Konventës përjashton shqyrtimin e një kërkese vetëm kur përmbushen këto kushte (shih *Arat kundër Turqisë,* nr. 10309/03, § 46, 10 nëntor 2009). Humbja e pretenduar e statusit "viktimë" të kërkueses përfshin shqyrtimin e natyrës të së drejtës konkrete, arsyet e paraqitura nga autoritetet vendëse në vendimin e tyre dhe vijimësinë e pasojave negative për kërkuesen pas vendimit (shih *Freimanis dhe Līdums kundër Letonisë,* nr. 73443/01 dhe 74860/01, § 68, 9 shkurt 2006).

53. Duke u kthyer te çështja konkrete, Gjykata vëren se kundërshtimi i Qeverisë, në thelb mbështetet tek të njëjtat argumente të paraqitura në kërkesën e saj sipas nenit 37 § 1 (b) të Konventës, duke kërkuar që çështja të çregjistrohej nga lista e çështjeve të Gjykatës (shih paragrafin 43 më sipër). Në këto rrethana, për të njëjtat arsye si ato të paraqitura në paragrafët 45–47 më sipër, Gjykata e rrëzon kundërshtimin e Qeverisë, në lidhje me statusin "viktimë" të kërkueses në mbështetje të nenit 34 të Konventës (shih, *mutatis mutandis, Nada kundër Zvicrës,* [DHM], nr. 10593/08, § 129, GJEDNJ 2012).

54. Së fundmi, në çështjen *Delijorgji kundër Shqipërisë* (nr. 6858/11, § 59, 28 prill 2015) Gjykata konstatoi se Qeveria nuk kishte cituar ndonjë vendim për të mbështetur pretendimin e saj se Gjykata Kushtetuese ofroi një zgjidhje efektive në respektim të së drejtës individuale për liri, garantuar në nenin 5 të Konventës. Megjithatë, në çështjen konkrete, Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi ndonjë problematikë *ratione materiae* tek ankimi, në lidhje me të drejtën për liri, që ishte paraqitur përpara gjykatës nga kërkuesja. Përkundrazi, gjykata bëri një shqyrtim paraprak dhe konstatoi se paraburgimi i kërkueses kishte përfunduar (shih paragrafin 18 më sipër). Gjithashtu, nga praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 39–41 më sipër) mund të vihet re se në të shkuarën, gjykata ka pranuar dhe ka gjykuar ankime me anë të të cilave pretendohej se kishte pasur privim të paligjshëm të lirisë. Për më tepër, Qeveria nuk bëri ndonjë parashtrim se ankimi kushtetues i kërkueses nuk duhet të konsiderohet si një ankim që përbën një zgjidhje efektive, sipas qëllimeve të afatit gjashtëmujor. Për sa më sipër, Gjykata është e mendimit se kërkesa u paraqit brenda afatit gjashtëmujor.

55. Gjykata thekson se ankesat nuk janë as të pambështetura në fakte dhe as të papranueshme sipas shkaqeve të listuara në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsye, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

56. Kërkuesja parashtroi se në urdhrin për arrestimin e saj, vendimet vendëse të datës 5 nëntor 2013 dhe 27 nëntor 2013 nuk kishin cituar arsyet e duhura dhe të mjaftueshme dhe nuk i ishin referuar rrethanave të saj personale. Ajo shtoi se ankimet e saj ndaj arrestimit të saj nuk ishin shqyrtuar plotësisht.

57. Qeveria i kundërshtoi këto argumente. Ajo parashtroi se secili prej vendimeve vendës kishte dhënë në mënyrë të detajuar arsyet se përse kërkuesja ishte e dyshuar për veprën për të cilën ishte akuzuar.

58. Në vijim, Qeveria parashtroi se gjykatat vendëse kishin bërë një vlerësim të detajuar të faktorëve përkatës për nivelin e rrezikut që kërkuesja t'i fshihej drejtësisë dhe të kryente përsëri një shkelje. Në të njëjtën kohë, Qeveria deklaroi se duke qenë se kërkuesja ishte vetëdorëzuar përpara autoriteteve, në dhënien e urdhrit për burgimin e saj, gjykatat vendëse nuk i ishin referuar rrezikut që kërkuesja mund të arratisej.

59. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, gjykatat vendëse kishin marrë në konsideratë faktin se kërkuesja dyshohej se kishte shpërdorur pozitat e

saj dhe ndikimin e saj ndaj zyrtarëve të tjerë publik. Për këtë arsye, sipas Qeverisë, kishte pasur mjaftueshëm elemente që tregonin për një rrezik se nëse nuk mbahej në arrest në burg, kërkuesja do të ndikonte mbi dëshmitarët dhe bashkë-të-dyshuarit e tjerë me të.

60. Në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, Qeveria parashtroi se mbështetur në karakteristikat specifike të asaj gjykate, ishte normale që kushtet e pranueshmërisë, në lidhje me ankimet paraqitur përpara saj ishin më strikte dhe përfshinin një kërkesë, sipas së cilës kërkuesja duhej të justifikonte se ajo kishte një interes ligjor në paraqitjen e ankimit (shih paragrafin 27 më sipër). Sipas këndvështrimit të Qeverisë, Gjykata Kushtetuese e kishte vlerësuar këtë kërkesë në të njëjtën mënyrë që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerësonte nëse një kërkues kishte "statusin e viktimës", sipas nenit 34 të Konventës. Në çështjen konkrete, sipas Qeverisë, kërkuesja nuk e kishte përmbushur atë kusht, pasi në kohën kur ishte shqyrtuar ankimi i saj kushtetues, ajo kishte kaluar në arrest shtëpie; për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese kishte vepruar në mënyrë korrekte duke kundërshtuar ankimin e saj.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

61. Parimet e përgjithshme të zbatueshme në lidhje me justifikimin dhe kohëzgjatjen e paraburgimit përcaktohen në vendimin *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], nr. 23755/07, §§ 87–91, 5 korrik 2016.

62. Gjykata përsërit veçanërisht se, teksa paragrafi 1 (c) i nenit 5 parashikon arsyet mbi të cilat paraburgimi mund të jetë i lejueshëm në radhë të parë (shih *De Jong, Baljet dhe Va nden Brink kundër Holandës*, 22 maj 1984, § 44, seria A nr. 77); paragrafi 3, që krijon të tërën së bashku me përcaktimin e mëparshëm, parashikon garanci të caktuara procedurale, duke përfshirë rregullin se gjykimi pezull për burgimin nuk duhet të tejkalojë afatin e arsyeshëm, duke rregulluar në këtë mënyrë kohëzgjatjen e tij (shih *Buzadji*, cituar më sipër, §§ 86).

63. Sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës mbështetur në nenin 5 § 3, vijimi i një dyshimi të arsyeshëm është kusht *sinë qua non* për vlefshmërinë e paraburgimit, por pasi ka kaluar një kohë e caktuar – që do të thotë që prej vendimit të parë gjyqësor që urdhëron arrestin me burg (shih *Buzadji*, cituar më sipër, § 102) – ai nuk është më i mjaftueshëm. Atëherë, Gjykata duhet të vendosë: 1. nëse arsye të tjera cituar nga autoritetet gjyqësore vijojnë të justifikojnë privimin e lirisë; dhe 2. në rastet kur këto arsye ishin "të duhurat" dhe "të mjaftueshme", nëse autoritetet vendëse kanë shfaqur "kujdes të veçantë" në realizimin e procesit. Justifikimi për çfarëdo periudhe burgimi, pavarësisht se sa e shkurtër ka qenë kjo periudhë burgimi, duhet të demonstrohet në mënyrë bindëse nga autoritetet (shih, midis shumë autoritetesh të tjerë, *Idalov kundër Rusisë* [DHM], nr. 5826/03, § 140, 22 maj 2012; dhe *Buzadji*, cituar më sipër, § 87).

64. Justifikimet që janë vlerësuar arsye "të duhura" dhe "të mjaftueshme" – përveç ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm – në praktikën gjyqësore të Gjykatës kanë përfshirë arsye të tilla si rreziku për t'u arratisur, rreziku i presionit ndaj dëshmitarëve ose rreziku i ndërhyrjes në prova, rreziku për marrëveshje të fshehta, rreziku për të kryer përsëri vepra penale, rreziku për të prishur rendin publik dhe nevoja për të mbrojtur personin e burgosur (ibid., § 88, me referenca të tjera).

65. Deri në dhënien e dënimit, një i pandehur duhet të konsiderohet i pafajshëm dhe qëllimi i përcaktimit konkret, kryesisht, është të kërkojë lirimin e tij ose të saj paraprak menjëherë pasi burgimi i tij ose saj nuk është më i arsyeshëm (shih, *McKay kundër Mbretësisë së Bashkuar* [DHM], nr. 543/03, § 41, GJEDNJ 2006-X, dhe *Buzadji*, cituar më sipër, § 89).

66. Çështja nëse një periudhë e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte. Aspekti nëse është e arsyeshme që një i pandehur të qëndrojë në burg duhet të vlerësohet mbi faktet e secilës çështje dhe sipas tipareve të saj specifike. Vijimësia e burgimit mund të justifikohet në një çështje të caktuar vetëm nëse ka tregues specifik për një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale parashikuar në nenin 5 të Konventës (shih për shembull, *Labita kundër Italisë* [DHM], nr. 26772/95, § 152, GJEDNJ 2000-IV, dhe *Kudła kundër Polonisë* [DHM], nr. 30210/96, §§ 110 *et seq.,* GJEDNJ 2000 XI; shih edhe *Buzadji*, cituar më sipër, § 90).

67. Në radhë të parë u takon autoriteteve gjyqësore vendëse të garantojnë, se në çdo çështje,

paraburgimi i një të pandehuri nuk tejkalon afatin e arsyeshëm. Sipas rastit, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, ata duhet të shqyrtojnë të gjitha faktet pro ose kundër ekzistencës së kërkesës përmendur më sipër të interesit publik ose që justifikojnë shmangien e nenit 5, dhe më pas duhet t'i përfshijnë ato në vendimet e tyre për kërkesat për lirim (shih *Buzadji*, cituar më sipër, § 91). Me konsideratë të veçantë ndaj rrezikut, se nëse lirohet, i dyshuari do të kryej përsëri një vepër penale, duhet t'i kushtohet vëmendje, *inter alia,* natyrës dhe rëndësisë së akuzave ndaj të pandehurit, të dhënat e tij ose të saj penale dhe karakteri ose sjellja e tij apo e saj, që do të tregonin se ai ose ajo e paraqiste një rrezik të tillë (shih, për shembull, *Merčep kundër* Kroacisë, nr. 12301/12, § 96, 26 prill 2016; *Šoš kundër Kroacisë*, nr. 26211/13, § 95, 1 dhjetor 2015; dhe *Magnitskiy dhe të Tjerët kundër Rusisë*, nr. 32631/09 dhe 53799/12, § 221, 27 gusht 2019).

68. Në ushtrimin e funksionit të saj në këtë pikë, Gjykata duhet të garantojë se argumentet e gjykatave vendëse në favor të dhe kundër lirimit nuk duhet të jenë "të përgjithshme dhe abstrakte" (shih, për shembull, *Smirnova kundër Rusisë,* nr. 46133/99 dhe 48183/99, § 63, GJEDNJ 2003-IX (ekstrakte)), por përmbajnë referenca për fakte specifike dhe rrethana personale duke justifikuar paraburgimin e një kërkuesi (shih, *mutatis mutandis, Panchenko kundër Rusisë,* nr. 45100/98, § 107, 8 shkurt 2005).

69. Në rastin kur rrethanat që mund të çonin në arrestimin me burg të një personi mund të ekzistonin, por nuk përmendeshin në vendimin e gjykatave vendëse, nuk është detyrë e Gjykatës t'i përcaktojë ato dhe të marrë vendin e autoriteteve vendëse, të cilat kanë vendosur për paraburgimin e kërkuesit (shih *Bykov kundër Rusisë* [DHM], nr. 4378/02, §§ 66, 10 mars 2009, dhe *Giorgi Nikolaishvili kundër Gjeorgjisë*, nr. 37048/04, § 77, 13 janar 2009).

b) Zbatimi i atyre parimeve

i. Proceset përpara gjykatave të rrethit dhe të apelit

70. Kërkuesja nuk e kundërshtoi konstatimin se në periudhën konkrete ekzistonte një dyshim i arsyeshëm se ajo kishte kryer një vepër penale. Gjykata nuk ka arsye që të gjykojë ndryshe. Sipas rastit, çështja e diskutueshme është nëse, në caktimin e një dyshimi të arsyeshëm, gjykatat vendëse shtuan arsyet e duhura dhe të mjaftueshme për të mbështetur vendimet e tyre për të mbajtur në arrest me burg kërkuesen (shih paragrafin 63 më sipër).

71. Në lidhje me këtë aspekt, vendimi i datës 5 nëntor 2013 i Gjykatës së Rrethit Tiranë i referohej rrezikut se kërkuesja do t'i fshihej drejtësisë (shih paragrafin 7 më sipër), që është një nga arsyet e lejueshme për të urdhëruar arrestin me burg. Megjithatë, siç u parashtrua nga Qeveria, Gjykata e Rrethit Tiranë nuk kishte paraqitur ndonjë arsye se përse ishte e mendimit se kërkuesja paraqiste rrezikun për t'u larguar. Gjithashtu, sipas kërkesave të praktikës gjyqësore të Gjykatës, ajo nuk përcaktonte as ndonjë rrethanë personale të kërkueses që e çonin gjykatën në përfundimin se ajo ishte një rrezik për t'u arratisur (ibid.).

72. Vendimi i mëpasshëm i Gjykatës së Rrethit Tiranë i datës 27 nëntor 2013 nuk përmbante ndonjë referencë për faktin se kërkuesja pretendohej të paraqiste rrezikun për t'u arratisur. Në këto rrethana, Gjykata e Rrethit Tiranë gjykonte se ekzistonte rreziku se nëse lihej e lirë, kërkuesja do të kryente përsëri një vepër penale. Edhe rreziku për të kryer përsëri një vepër penale përbën arsye për të vijuar dënimin me burgim (shih paragrafin 64 më sipër). Megjithatë, edhe gjykata e apelit mbeti vetëm me deklarimin se ekzistonte një rrezik pa shpjeguar se çfarë elementesh e kishin çuar në arritjen e atij konkluzioni (shih paragrafin 14 më sipër). Veçanërisht, përveç referencës për rëndësinë e akuzave, gjykata nuk shpjegonte se çfarë peshe i jepte, për shembull, të dhënave kriminale të mëparshme të kërkueses, nëse kishte ndonjë të tillë, dhe karakterit apo sjelljes së saj (shih paragrafin 67 më sipër).

73. Në lidhje me këtë aspekt, kërkuesja parashtroi se nuk kishte ekzistuar asnjë rrezik që ajo të kryente përsëri një vepër penale, pasi ndërkohë ajo ishte pezulluar nga pozicioni i saj zyrtar (shih paragrafin 12 më sipër). Gjykata mendon së një parashtrim i tillë kërkon një përgjigje. Veçanërisht, është e paqartë se përse Gjykata e Rrethit Tiranë gjykonte se kërkuesja ende paraqiste një rrezik për të kryer përsëri një vepër, edhe pse ajo ishte pezulluar nga detyra në ushtrimin e së cilës ajo ishte akuzuar se kishte kryer veprën konkrete.

74. Gjykata vëren se vendimet vendëse të datave 5 dhe 27 nëntor 2013 mbështeteshin kryesisht në pasojat e rënda financiare të veprës konkrete dhe në faktin se kërkuesja dyshohej se e kishte kryer

këtë vepër, duke shpërdorur detyrën e saj publike (shih paragrafët 5–14 më sipër). Megjithatë, rëndësia e veprës apo pasojat e saj nuk përbëjnë arsye të pavarura që justifikojnë burgimin dhe të vetme ato mund të mos justifikojnë privimin e një të dyshuari nga liria e tij apo e saj, në rast se nuk konsiderohet vlerësimi i ekzistencës së arsyeve të lejueshme me anë të të cilave mund të urdhërohet burgimi, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës (shih paragrafin 64 më sipër).

75. Qeveria parashtroi se paraburgimi i kërkueses ishte justifikuar me rrezikun që ajo do të bënte presion ndaj dëshmitarëve ose do të bashkëpunonte me të bashkëpandehurit. Megjithatë, Gjykata vëren se gjykatat vendëse nuk i referoheshin një rreziku të tillë në vendimet e tyre të datave 5 dhe 27 nëntor 2013 (shih paragrafët 5–14 më sipër). Në këtë mënyrë, nuk i takon Gjykatës që të zërë vendin e autoriteteve vendëse dhe përcaktojë këto arsye të reja për burgim në mënyrë prapavepruese (shih paragrafin 69 më sipër).

76. Së fundmi, Gjykata vëren se vendimet vendëse të datave 5 dhe 27 nëntor 2013 konstatonin se masat alternative ndaj ndalimit me burg të kërkueses konsideroheshin të papërshtatshme (shih paragrafët 8 dhe 14 më sipër). Megjithatë, përveçse një deklarate formale se masat e tjera ishin marrë në konsideratë, vendimet vendëse nuk i referoheshin në thelb masën e konsideratës që gjykatat vendëse kishin treguar ndaj masave alternative për të siguruar që kërkuesja do të paraqitej në gjykim (shih *Jablonski kundër Polonisë*, nr. 33492/96, § 83, 21 dhjetor 2000).

ii. Procesi përpara gjykatave të larta

77. Edhe pse shumë prej kërkesave të përmendura më sipër në lidhje me vendosjen e një mase ndalimi tashmë ishin njohur nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë (shih paragrafin 38 më sipër), Gjykata vëren se apelimi i kasacionit të kërkueses mbështetur në kërkesat e përmendura ishte kundërshtuar nga Gjykata e Lartë me anë të një vendimi *de plano* papranueshmërie.

78. Gjykata Kushtetuese nuk i kishte shqyrtuar argumentet e saj për meritat, duke e kundërshtuar ankesën e saj me arsyet e vetme se ajo nuk ishte mbajtur më tej në burg. Në lidhje me këtë, në një sërë çështjesh të lidhura me rrethana të krahasueshme, Gjykata kishte konstatuar një shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës, duke u mbështetur në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë ku ankimet ishin deklaruar të papranueshme, në rastin kur një vendim i ri, në lidhje me ndalimin me burg të ankuesit ishte miratuar përpara se gjykata të jepte vendimin e saj (shih *Bernobić kundër Kroacisë*, nr. 57180/09, § 93, 21 qershor 2011; *Krnjak kundër Koracisë,* nr. 11228/10, § 54, 28 qershor 2011; *Šebalj kundër Kroacisë*, nr. 4429/09, § 223, 28 qershor 2011; dhe *Margaretić kundër Kroacisë*, nr. 16115/13, § 119-121, 5 qershor 2014).

79. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kufizimi i së drejtës së kërkueses për një shqyrtim kushtetues të periudhës së parë të burgimit të saj për mungesë të një interesi legjitim, dhe rëndësie, nuk përcaktohej specifikisht nga ligji vendës. Një kufizim i tillë ishte identifikuar nga Gjykata Kushtetuese në interpretimin e saj të nenit 134 § 2 të Kushtetutës, i cili parashikon se individët që ankohen përpara Gjykatës Kushtetuese duhet të justifikojnë një interes personal në proces (shih paragrafin 27 më sipër).

80. Siç përcaktohet nga Qeveria, pozicioni i Gjykatës për të shqyrtuar pajtueshmërinë me ligjin vendës është i kufizuar, pasi fillimisht u takon autoriteteve vendëse (kryesisht gjykatave) të interpretojnë dhe zbatojnë ligjin vendës (shih, midis autoriteteve të tjera, *Kudrevičius dhe të Tjerët kundër Lituanisë* [DHM], nr. 37553/05, § 110, GJEDNJ 2015, dhe *Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy kundër Finlandës* [DHM], nr. 931/12, § 144, 27 qershor 2017). Në rast se interpretimi nuk është arbitrar apo dukshëm i paarsyeshëm, roli i Gjykatës kufizohet në përcaktimin nëse efektet e atij interpretimi janë në përputhje me Konventën (shih *Radomilja dhe të Tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, § 149, 20 mars 2018, dhe *Qendra për Demokraci dhe Shtetin e së Drejtës kundër Ukrainës,* nr. 10090/16, § 108, 26 mars 2020, me referenca të tjera).

81. Duke u kthyer te rrethanat konkrete, Gjykata nuk është e bindur se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 24 shkurt 2016 apo vërejtjet e Qeverisë përpara Gjykatës përcaktonin bindshëm arsyet për përfundimin se kërkuesja nuk kishte interes personal në kundërshtimin e ligjshmërisë së periudhës së parë të burgimit të saj.

82. Për të arritur në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ishte mbështetur ekskluzivisht në faktin se paraburgimi i kërkueses ishte ndërprerë. Megjithatë, siç është përmendur tashmë në

paragrafët 46–47 më sipër, vendimi i datës 19 qershor 2014, i cili e vendoste kërkuesen në arrest shtëpie nuk përfshinte ndonjë përcaktim të ligjshmërisë për periudhën e parë të paraburgimit të saj.

83. Siç edhe përcaktohet nga gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese me qëndrim kundërshtues, në datën kur Gjykata Kushtetuese miratoi vendimin e saj, kërkuesja kishte vuajtur tashmë privimin e lirisë së saj; në këtë mënyrë, ajo mund të përfitonte në mënyrë legjitime nga një shqyrtim kushtetues *post facto* për periudhën e parë të burgimit të saj (shih paragrafët 19 dhe 45 më sipër). Një shqyrtim i plotë nga Gjykata Kushtetuese mund të kishte çuar në konstatimin se kërkuesja ishte mbajtur në burgim në shkelje të së drejtës së saj për liri. Përveç interesit moral në marrjen e rezultatit, një ndihmë e tillë deklarative mund të hapte rrugën edhe për një kërkesë për kompensim mbi arsyet për burgim të paligjshëm sipas nenit 5 § 5 të Konventës (shih *S.T.S kundër Holandës*, nr. 277/05, § 61, GJEDNJ 2011), një e drejtë që njihet edhe nga ligji vendës (shih paragrafët 34–37 më sipër).

84. Në çdo rast, refuzimi i Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar meritat e ankesës së kërkueses nënkuptonte se mangësitë në arsyetimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të apelit nuk ishin korrigjuar, dhe cenimi i së drejtës së kërkueses për liri nuk ishte kompensuar as nga shqyrtimi i kasacionit apo atij kushtetues në nivel vendës.

iii. Përfundim

85. Konstatimet e mësipërme janë të mjaftueshme për ta bërë Gjykatën të arrijë në përfundimin se gjykatat vendëse nuk kanë dhënë arsyet e duhura dhe të mjaftueshme për të mbështetur vendimet e tyre, në lidhje me periudhën e parë të burgimit të kërkueses.

86. Për këtë arsye, është shkelur neni 5 § 3 i Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

87. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.".

A. Dëmi

88. Kërkuesja kërkoi 13,626,777.7 lekë (116,658.49 euro (EUR)) për dëmin pasuror dhe jopasuror. Ajo parashtroi një sërë pasqyrash bankare, në lidhje me shpenzimet e bëra nga familja e saj në lidhje me burgimin e saj si edhe një raport nga eksperti ku përcaktohej dëmi i saj moral dhe psikologjik.

89. Qeveria parashtroi se pretendimi ishte i pambështetur në fakte dhe i tepërt.

90. Gjykata nuk gjen ndonjë lidhje rastësore midis shkeljes së konstatuar dhe pretendimit për dëm pasuror. Duke pasur në konsideratë natyrën e shkeljes së konstatuar, Gjykata, duke gjykuar mbi baza të barabarta, i akordon kërkueses 4,500 euro për dëmin jopasuror.

B. Kostot dhe shpenzimet

91. Gjithashtu, kërkuesja kërkoi 5,500 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendëse dhe në Gjykatë. Ajo paraqiti dy fatura prej 2,500 eurosh dhe 3,500 eurosh në mbështetje të kërkesës së saj.

92. Qeveria parashtroi se shumat e pretenduara ishin të tepruara dhe se faturat e dorëzuara nuk ishin paraqitur në formatet e miratuara zyrtarisht për faturat.

93. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkues ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet vetëm për aq sa është provuar se ato janë bërë faktikisht dhe kanë qenë të nevojshme dhe janë të arsyeshme sipas kuantit. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesja ka ndjekur proceset në katër nivele të gjykatave vendëse përpara se të dorëzonte kërkesën e saj përpara Gjykatës. Në të shkuarën, Gjykata ka kundërshtuar argumentin e Qeverisë, se pretendimet për kostot dhe shpenzimet duhet të mbështeten me fatura të miratuara zyrtarisht (shih *Sharxhi dhe të Tjerët kundër Shqipërisë,* nr. 10613/16, 11 janar 2018; *Delijorgji*, cituar më sipër, § 100; dhe *Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, § 129; 1 prill 2014). Ajo nuk gjen arsye për të arritur në një përfundim tjetër për këtë çështje.

94. Duke pasur parasysh dokumentet në zotërimin e saj dhe kriteret e mësipërme, Gjykata e konsideron të arsyeshme që të akordojë shumën prej 3,500 eurosh për mbulim të kostove për të gjitha kategoritë, plus taksat që mund t'i tarifohen kërkueses.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. Rrëzon kërkesën e Qeverisë për ta çregjistruar çështjen nga lista e saj e çështjeve;

2. Deklaron ankimin në mbështetje të nenit 5 § 3 të Konventës të pranueshëm;

3. Gjykon se është shkelur neni 5 § 3 i Konventës pasi gjykatat vendëse nuk kanë dhënë arsyet e duhura dhe të mjaftueshme për periudhën e parë të burgimit të kërkueses;

4. Vendos:

a) se Shteti përgjegjës duhet t'i paguajë kërkueses, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi është bërë i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që duhet të konvertohen në monedhën e shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e pagesës:

i. 4,500 euro (katër mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet, për dëmin jopasuror;

ii. 3,500 euro (tre mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës tremujore përmendur më sipër deri në shlyerje, për shumat e mësipërme do të paguhet interes i thjeshtë në normën e barabartë me normën margjinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës, plus tre për qind pikë.

5. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të kërkueses për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 21 shkurt 2023, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
SEKRETAR

Pere Pastor Vilanova
KRYETAR

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 88
Datë: 2023/06/13 14:51:05
6027ef5b-0c43-4caf-a314-087ec8257252

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë